



Koha

E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XII · Numri 3421 · e martë, 24 korrik 2018

17°C | 26°C

15 DEN



KOHA për kulturë

Fq.12-15

EDITORIAL

Lavdia që ia zë frymën lirisë



Asnjë pengesë nuk ka qenë aq konstante dhe aq e rëndë për t'u tejkaluar sa ka qenë konfuziteti dhe pasiguria për ta menaxhuar periudhën e pasrobërisë. Se sa një luftë e armatosur është e suksesshme, kjo varet nga cilësia e menaxhimit të paqes që prodhon ajo luftë dhe nga komponentja gjithëpërfshirëse e resurseve që kanë kontribuar para dhe gjatë luftës së armatosur. Fq.2

RAJON

Dialogu pa konsensus sjell "Demarkacionin 2"

Fq.16

KRONIKË

Vriten pesë anëtarë të një familje pas një konflikti për pronë

Fq.9



TAKIMI I LIDERËVE NË KËRKIM TË KONSENSUSIT

QEVERI TEKNIKE SIPAS MODELIT TË PËRZHINOS



Pushteti dhe opozita kanë arritur marrëveshje për KSHZ-në, financimin e partive politike dhe Qeverinë teknike sipas modelit të Përzhinos para çdo cikli zgjedhor. Nëse partitë harmonizojnë qëndrimet për referendumin, Kuvendi duhet të miratojë ndryshimet në Kodin Zgjedhor

Fq.3

ITKSH përkujton ndihmën amerikane

Shkup, 23 korrik - "Amerika për Shkupin", është titulluar ekspozita e cila pritet të mbahet me 26 korrik në Shkup, me rastin e 55 vjetori të tërmetit katastrofal që e kishte goditur kryeqendrën e Maqedonisë. Nën patronatin e Institutit të Trashëgimisë Kulturore dhe Shpirtërore të Shqiptarëve-Shkup, të enjten do të shënohet data e kobshme e 26 korrikut dhe njëkohësisht do të prezantohet materiale ek-

skluzive që deri më tani nuk kanë qenë të njohur për opinionin.

Kryetari i ITKSHSH-Shkup, Skender Asani, duke folur për këtë ngjarje të rëndësishme për shkupjanët, thekson se dokumentet dhe fotografitë që do të prezantohen edhe më tepër do ta bëjnë ta bëjnë të qartë ndihmën që ndër vite shteti Amerikan e jep për Maqedoninë dhe Shkupin.

Fq.5



EDITORIAL

LAVDIA QË IA ZË
FRYMËN LIRISË

Emin AZEMI

Asnjë pengesë nuk ka qenë aq konstante dhe aq e rëndë për t'u tejkaluar sa ka qenë konfuziteti dhe pasiguria për ta menaxhuar periudhën e pasrobërisë. Se sa një luftë e armatosur është e suksesshme, kjo varet nga cilësia e menaxhimit të paqes që prodhon ajo luftë dhe nga komponentja gjithëpërfshirëse e resurseve që kanë kontribuar para dhe gjatë luftës së armatosur. Një luftë e armatosur nuk mund të jetë e izoluar nga shumë faktorë të tjerë, që shpesh kanë qenë edhe vendimtarë për t'i dhënë luftës dinamizëm dhe gjithëpërfshirje.

Në aspektin psikologjik, liria mund të konceptohet në mënyra të ndryshme. Por procesi më i vështirë i triumfit të lirisë është kur armiku i jashtëm zëvendësohet me një demiurg të brendshëm. Të mposhtësh lakmitë e brendshme, thonë psikologët, është lufta më e vështirë e individit. Realiteti ynë, fatkeqësisht, është i mbushur plot me tipa që në luftë u treguan heronj, kurse në paqe u mundën nga lakmia dhe paraja. Heronjtë e luftës u shndërruan në antiheronj të paqes.

Një burrë i mençur i Karadaku që moti kishte pas thënë: 'Ka shumë njerëz trima që plumbi i pushkës vështirë i rrok në luftë, por pas luftës ai e vret veten me punët e pahijshme që bëjnë'.

Okupimi nga antiheronjtë mund të jetë vazhdimi i një lufte të pashpallur. Kauza kundër këtij okupimi do të duhej të jetë liria e vërtetë për të cilën janë flijuar heronjtë. Alternativa e luftës për liri është vetëm flijimi, por jo edhe zhvatja. Jo edhe monopolizimi i fryteve të luftës.

Duke rënë pahetueshëm në grackën e këtij monopolizimi, mediat, institucionet relevante dhe shoqëria në përgjithësi, sikur kanë harruar se luftërat në hapësirat shqiptare kishin edhe heronjtë e tyre të heshtur, por të mbetur jetim në ditët e sotme.

Të rënë në luftërat çlirimtare nuk therrizohen vetëm për idealet për të cilat kishin luftuar, por edhe për të reflektuar tek të gjallët idenë e menaxhimit të lirisë. Kështu është fati i heronjve. Ata, vdesin për të sprovuar ndërgjegjet e të gjallëve.

Kishte prej tyre që, në heshtje e pa zhurmë, gjithë jetën ia kishte kushtuar çështjes kombëtare, dhe nuk kishte mbetë mangut me asnjë obligim ndaj atdheut, por që sot ngelin nën hijen e kapotave të rënda të komandantëve.

Ngjarjet e ashtuquajtura të mëdha që po i servohen publikut, kanë filluar ta eklipsojnë njeriun e vogël, njeriun e sakrificave sublime gjatë viteve dramatike. Koncentrimi i vëmendjes publike vetëm tek manifestimet pompoze që po prodhojnë njëfarë lavdie politike dhe elektorale, e ka bërë pa sens kujdesin tonë moral e kombëtar ndaj atyre mikrongjarjeve që ishin magma vullkanike e historisë sonë më të re. Zakonisht në rrethana të tilla ka gjithnjë e më shumë personazhe të harruar të kësaj historie, të cilët paguan kosto të lartë qëndrimin e tyre të palëkundur në kushte kur ishin të vetëm para rreziqeve.

Të gjithë këta njerëz janë viktimë e harresës që vjen nga defokusimi publik. Në mungesë të një gazetarie pak a shumë hulumtuese, këta fate njerëzish ngelin "libra të mbyllur" që askush nuk ua lexon tmerret që përjetuan.

Kjo mënyrë e selektimit të heronjve me dhe pa epoleta, me dhe pa familje të mëdha, shkurajon idenë e të qenit kompakt në tribuna e manifestime ku mungojnë familjarët e atyre që sot as që u përmenden emrat. Kompleksi i epërsisë së të fuqishmëve, i atyre që sot veshjen e pushtetit e konsiderojnë privilegj e jo obligim, kanë konstruktuar një makineri të çuditshme për bluarjen e lavdisë për do interesa meskine e klienteliste.

Lavdia që ia zë frymën lirisë dhe bëhet peng i mburracakërisë, të përkujton tribalitetin e kohëve të lashta kur midis shkretëtirës së skamjeve e harambashllëqeve, lirishtësit projektonin delirin e luksit.

Presidenti ka filluar dialogun pa mandat të Kuvendit

"Kuvendi i Kosovës që mbledh përfaqësuesit e popullit duhet ta trajtojë aventurën personale të presidentit dhe të marrë qëndrim për veprimet e tij pa mandat dhe sjelljen e tij pa integritet.

1. Kuvendi i Kosovës nuk ka pse flet për dialog të ri kur ne deputetët nuk e diskutuam dialogun 'e vjetër'. Nuk bën të vrapohet në dialog të ri me Serbinë pa shqyrtuar premisat, procesin, marrëveshjet, zbatimet si dhe rezultatet e dialogut 2011-2017. Aq më tepër që Qeveria e ka sjellur një material me 38 faqe mbi arritjet dhe sfidat në zbatimin e marrëveshjeve të Brukselit. Ky material duhet diskutuar e shqyrtuar paraprakisht.
2. Në Kuvend të Kosovës nuk duhet të diskutohet për ecurinë e dialogut të ri dhe siguresat e tij, pa e marrë së pari qeveria barrën e provës së argumentimit pse na nevojitet ky dialog mu tash dhe çka është domethënia e tij. Këtu duhet përfshirë edhe sqarimin e kuptimit të saktë të shprehjeve si "normalizim i plotë", "normalizim", "marrëveshje ligjërishme e obligueshme", "kompromisi i dhimbshëm" etj.
3. Rendi i duhur i gjërave është që ne duhet t'i shtrojmë zyrtarisht kërkesa Serbisë, e pastaj ajo le të kërkojë dialog me neve. Serbia na ka aq shumë borxh, ne kemi se çka i kërkojmë asaj, apo jo? Prandaj, Kuvendi i Kosovës duhet që paraprakisht të diskutojë dhe miratojë kërkesat e Republikës së Kosovës ndaj Republikës së Serbisë.
4. Marrëveshja kryesore e Brukselit, ajo e 25 gushtit 2015, doli të jetë anti-kushtetuese. Secili prej shtatë kapitujve të 'Zajednicës' e ka shkelur Kushtetutën në gjithsej 23 nene! A nuk do të duhej të diskutojmë për përgjegjësinë politike, institucionale, morale etj. të akterëve? Ata zyrtarë e politikanë kosovarë që po insistojnë për këtë dialog të ri janë pak a shumë ata që e mbështetën 'Zajednicën'.
5. Pa mandatin e Kuvendit të Republikës, presidenti aktual e nisi dialogun e ri me Serbinë. Shpërfilli karakterin e republikës sonë parlamentare dhe jo vetëm. Thaçi takoi Vuçiqin e Serbisë pak ditë pasi takoi Medvedevin e Rusisë me ç'rast deklaroi "Kryeministrin Medvedev shkurtimisht e informova për zhvillimet në Kosovë dhe në rajon." Presidenti nuk duhet të jetë informator. Kuvendi i Kosovës që mbledh përfaqësuesit e popullit duhet ta trajtojë aventurën personale të presidentit dhe të marrë qëndrim për veprimet e tij pa mandat dhe sjelljen e tij pa integritet", kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje Albin Kurti me anë të një statusi në Facebook ka dhënë pesë pika për dialogun me Serbinë.

Nuk po bie shteti, por po pastrohet kalbëzimi më i madh i tij

"Duket si një nga ato fazat e zakonshme të luftës ordinere politike, ku partitë janë gati që për një "plesh" të djegin gjithë "jorganin". Por në fakt nuk është ashtu. Prej disa ditësh çështja më e rëndësishme është paralajmërimi për futjen e drejtësisë në kolaps. Vettingu është duke larguar (të paktën deri tani) gjysmën e gjykatësve dhe prokurorëve që ka marrë në shqyrtim. Gjykata Kushtetuese nuk ekziston më. Gjykata e Lartë po shkon drejt shkrirjes. Njerëzit më të rëndësishëm të sistemit të drejtësisë rezultojnë të lidhur me krimin apo të korruptuar. Gjykatat e niveleve më të ulëta rrezikojnë të mbeten pa gjykatës. Prokuroritë gjithashtu.

Në këto kushte, mazhboranca çdo ditë bën thirrje për të miratuar disa ndryshime në ligj për të rikthyer emërimet e gjykatësve e prokurorëve në tek KLD, dërsa të krijohen KLP e KLGJ. Opozita nuk bashkëpunon, e bindur se sistemi po shkon drejt bllokimit dhe kjo do të jetë një armë e mirë për të goditur reformën që e kritikoi aq fort.

Shumëkush ka marrë penën e po shkruan se vendi anëtar i NATO-s, vendi që pret hapjen e negociatave, s'ka Gjykatë Kushtetuese e Gjykatë të Lartë. Ata që kundërshtojnë reformën po fërkojnë duart, duke thënë: ja kjo është çorba që u gatua me bekimin e Donald Lushës. Por a po shkon shteti drejt rënies, a po shkon drejtësia drejt zhbërjes totale? Në dukje po. Një shtet pa gjykatë kushtetuese funksionale e gjykatë të lartë, nuk është më një shtet", shkruan në profilin e tij në Facebook, gazetari nga Tirana, Mentor Kikia.

MEDIACitate

Pacolli nuk mund të krahasohet me Gjuriqin

Zëvendësi i Zyrës për Kosovën në Qeverinë e Serbisë, Petar Petkoviq, ka kundërshtuar krahasimin ndërmjet shefit të tij, Makro Gjuriq, dhe ministrit të Jashtëm të Kosovës, Behgjet Pacolli. Duke e bërë këtë, ai është përpjekur të mohojë institucionet e Kosovës, por edhe të fyejë personalitetin e Pacolli, duke e quajtur "tajkun të pasuruar në kurriz të të varfërve në Kosovë".

Ministri në qeverinë e institucioneve të përkohshme të administrimit në Prishtinë, Behgjet Pacolli, siç e quan Beograd zyrtar Qeverinë e Republikës së Kosovës, nuk mund të krahasohet me asgjë me drejtorin e Zyrës për Kosovën, Marko Gjuriq, theksohet në kumtesën e kësaj zyre.

"Ai dhe Marko Gjuriq kurrë nuk do të jenë të njëjtë, sepse Marko Gjuriq ka qenë në tokën e vet, kur Pacolli dhe të tjerët si ai vendosën t'i dërgojnë banditët e armatosur deri në dhëmbë të qytetarët paqësorë dhe duarthatë", ka thënë zëvendësdrejtori i Zyrës për Kosovën, Petar Petkoviq.

Veç kësaj, tërheq vërejtjen Petkoviq, ata dallojnë edhe për shkak se Marko Gjuriq është në krye të institucionit të një shteti sovran, ndërsa Pacolli është ministër i shtetit inekzistent dhe në krye të ministrisë që nuk ekziston sipas UNMIK-ut dhe Kornizës Kushtetuese e dhe që është e pavërtetë për pjesën më të madhe të njerëzimit, mu sikur që është edhe e ashtuquajtura Ministri e Forcës së Sigurisë, ka thënë ai.

"Po ashtu, Pacolli është tajkun, i cili u pasurua në kohën e tranzicionit derisa qindra mijëra qytetarë për shkak të varfërisë e braktisën Kosovën, ndërsa Marko Gjuriq është personi i cili nga ideali dhe dashuria lufton për popullin e vet, vendin e vet dhe të gjithë ata që jetojnë në të", theksohet në kumtesë. Petkoviq ka shtuar se Pacolli nuk duhet të frikësohet nga askush që ngre tre gishtërinj, sepse ajo është shenjë e dashurisë serbe ortodokse e trinisë së shenjtë dhe për habi, edhe pse tërë jetën ka qenë i rrethuar me fqinj të serbë, ai nuk ka mësuar asgjë për kulturën tonë.

Mediet serbe kanë vërshuar me lajme për mundësinë ose jo të vizitës së Pacolli në Sanxhak.

Daçiq më herë kishte aluduar se shkruarja e Pacolli në Novi Pazar mund të përfundojë si qëndrimi i Gjuriqit në Mitrovicë më 26 mars, kur ai ishte arrestuar e më pas liruuar nga Policia e Kosovës.

(Gazeta Observer, 23 korrik)

TAKIMI I LIDERËVE NË KËRKIM TË KONSENSUSIT

QEVERI TEKNIKE SIPAS MODELIT TË PËRZHINOS

Pushteti dhe opozita kanë arritur marrëveshje për KSHZ-në, financimin e partive politike dhe Qeverinë teknike sipas modelit të Përzahinos para çdo cikli zgjedhor. Nëse partitë harmonizojnë qëndrimet për referendumin, Kuvendi duhet të miratojë ndryshimet në Kodin Zgjedhor



VMRO-DPMNE-së që të bëhen ndryshime ligjore që do të mundësojnë që një Qeveri teknike të organizojë të gjitha ciklet zgjedhore parlamentare, sipas modelit të Marrëveshjes së Përzahinos. Jemi marr vesh që takimi i liderëve të përfundojë gjatë ditë së mërkurë, pra të mos ketë shtyrje të mëtejme. Se si do të merremi vesh varet nga të gjithë ne brenda. Tani do të bisedojmë për çështjet tjera, për pyetjen e referendumit, karakterin dhe datën e mbajtjes së referendumit. Këtë si shumicë parlamentare e bëjmë që të dëshmojmë përkushtim ndaj gjithë këtij procesi. Maqedonia do të jetë anëtare e NATO-s dhe e Bashkimit Evropian, ka deklaruar kryeministri Zaev.

Partitë kanë arritur marrëveshje që përbërja e KSHZ-së të bëhet sipas ligjit aktual, pra me dy të tretat e votave në Kuvend, e jo me shumicë të thjeshtë siç pretendonte pushteti.

Ndërsa janë pajtuar edhe për kontrollin e financimeve të partive, në veçanti gjatë cikleve zgjedhore. Kjo u konfirmua edhe nga lideri i partisë opozitare VMRO-DPMNE, Hristijan Mickovski.

“Me çështjet për të cilat kemi arritur marrëveshjet garantohet një procesi zgjedhor i suksesshëm pavarësisht se kur do të mbaheshin ato, apo se do të jetë të rregullta apo të ndihet komode pasi do të ketë kushtet e njëjta që kishte opozita para kësaj Qeverie. Pra, do të kemi Qeveri e cila do të sigurojë mbarëvajtje të zgjedhjeve”, ka deklaruar Mickovski.

Partitë kanë dallime edhe për pyetjen e referendumit, e cila siç ka bërë të ditur Zaev, do të jetë përafërsisht në formën se “a jeni për anëtarësimin e Maqedonisë në NATO dhe BE me pranimin e marrëveshjes me Greqinë”.

Por, opozita këtë formulim e ka quajtur manipulues pasi kërkon që pyetja të ketë lidhshmëri edhe me ndryshimin e emrit të shtetit, që sipas saj është edhe esenca e marrëveshjes me Greqinë. VMRO-ja, sipas partive në pushtet, në mënyrë indirekte ka kërkuar edhe amnisti për zyrtarët e saj të akuzuar për dhunën në Kuvend përmes ndryshimeve ligjore, por kjo është mohuar nga kryetari i saj, Hristijan Mickovski. Ai tha se për amnisti nuk është diskutuar fare në takimin e liderëve dhe sipas tij, ky ka qenë tentim për defokusimin e opinionit nga politikë dhe qeverisë.

Nëse partitë harmonizojnë qëndrimet për referendumin, Kuvendi duhet të miratojë ndryshimet në Kodin Zgjedhor, përkatësisht të emërojnë përbërjen e re të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve që duhet të organizojë referendumin, i cili bazuar në qëndrimet e kryeministrit Zaev, do të mbahen në shtator po në fillim të muajit tetor. Pas kalimit të referendumit, pason procedura për ndryshimet kushtetuese, por vetëm nëse referendumi kalon me sukses. Marrëveshja për emrin e ri të shtetit “Maqedonia Veriore”, duhet të ratifikohet edhe në Parlamentin e Greqisë, në të kundërtën, bazuar në marrëveshjes mes dy shteteve, ajo nuk do të jetë e vlerëshme nëse ndonjëra nga palët nuk e zbaton deri në fund.



Osmani: Vendi nuk ka të ardhme pa BE dhe NATO

Zëvendëskryeministri i Maqedonisë për Çështjet Europiane, Bujar Osmani konsideron se kundërshtimi i opozitës për marrëveshjen për emrin me Greqinë, e cila, siç thotë është marrëveshje për gjeneratat e ardhshme dhe jo e zgjedhjeve të ardhshme, do ta komplikojë gjendjen politike në vend. Sidoqoftë, ai shpreson ende se VMRO-DPMNE do të kuptojë se vendi nuk ka të ardhme pa BE dhe NATO. Ai është i bindur se edhe pa mbështetjen e opozitës procesi mund të jetë i suksesshëm, para së gjithash për shkak të besimit në zgjedhjen dhe vlerësimin e popullit. “Opozita ende e mban peng këtë proces e me atë edhe të ardhmen e shtetit. Do të donim që këtë betejë ta zhvillojmë së bashku me opozitën, por, nëse nevojitet, do ta bëjmë atë edhe pa ta dhe do të kemi sukses. besoj se me mbështetjen e madhe të qytetarëve do të arrijmë ta bëjmë atë në kohën e parashikuar”, thotë Osmani në intervistën për gazetën greke “Ethnos”.

Koha Zejnulla VESELI

Shkup, 23 korrik – Takimi i tretë i liderëve të katër partive do të vazhdojnë deri në arritjen e marrëveshjes në lidhje me referendumin: Ilojin, datën dhe mënyrën si të organizohet dhe se takim tjetër nuk do të ketë. Kështu deklaroi kryeministri Zoran Zaev pas gjashtë orë bisedimeve me liderët e partive tjera në klubin e deputetëve kryeministri Zaev informoi se është arritur marrëveshje për pikën e parë të bisedimeve që ka të bëjë me formimin e Qeverisë teknike në formatin e marrëveshjes së Përzahinos që njëherë ishte dhe kërkesa e partisë opozitare VMRO-DPMNE.

“Kemi pranuar kërkesën e

PAS AKSIDENTIT FATAL NË RRAMANLI TË KUMANOVËS

Hekurudhat e Maqedonisë nuk marrin përgjegjësinë

Shkup, 23 korrik - Pas ngjarjes tragjike që ndodhi dje në fshatin Rramanli të Kumanovës ku tre persona humbën jetën si pasojë e goditjes nga treni, drejtuesi i Hekurudhave të Maqedonisë, Infrastruktura Irfan Hasani shfaqësoi veten nga përgjegjësia duke shtuar se në kalimin ku ndodhi aksidenti në atë moment ka punuar shenja sinjalizuese, duke treguar për këtë edhe video nga kamerat e sigurisë.



“Në këtë rast besoj se Prokuroria është ajo e cila më së miri do reflektoj dhe do të paraqes faktet.

Njeriu i cili ka kaluar në moment

në kalimin rrugë-hekurudhë nuk iu është përmbajtur shenjave të sinjalizimit, ka kaluar në semafor të kuq në momentin kur semafori i kuq ka

qenë i hapur dhe sirena me zë ka qenë e lëshuar. Njeriu i cili në këtë moment ka drejtuar makinën ndalet në mes të rrugës”,

tha Irfan Asani, drejtor i Hekurudhave të Maqedonisë, transmeton Zhurnali.

Tre viktimat nga Haraçina të cilët një ditë më parë u goditën nga treni u varrosën sot, ndërsa personi i katërt i lënduar nga ky aksident është jashtë rrezikut për jetën.

TAKIMI I LIDERËVE PËRCAKTON KODIN ZGJEDHOR

Shkup, 23 korrik - Në pritje të rezultateve nga takimi i liderëve deputetët tejkalan votimin me procedurë të përshpejtuar të ndryshimeve në kodin zgjedhor. “Propozim ligji për ndryshim të ligjit me procedurë të përshpejtuar, leximi I dytë dhe I tretë. Duke pasur parasysh se ende po zhvillohen bisedimet për gjetjen e konsensusit për këtë çështje, propozoj që të kalojmë në pikën e rradhës, ndërsa në këtë pikë të kthehem pas arritjes së konsen-

susit për këtë çështje”, është shprehur kryeparlamentari Talat Xhaferi.

Qeveria pati propozuar që KSHZ të zgjidhet me 61 vota e jo me 81 sikurse ishte deri më tani. Kundër ndryshimeve VMRO-DPMNE dorëzoi 401 amendamente në komisionin për çështje europiane.

Kryetari i komisionit Artan Grubi e mbylli debatin për shkak të mos pasjes së kohës së duhur që të debatohet gjithë deputetët e lajmëruar për debat.

Ndërkohë parlamenti gjatë ditës votoi llogarinë përfundimtare të buxhetit të shtetit, ligjin e deputetëve gjegjësisht shkurtimin e pagesave për rrugë të deputetëve në 20%.

Kuvendi mbështeti edhe nevojën për ndryshimet e ligjit për gjykatës dhe prokurorë publik.

Deputetët shqyrtuan edhe raportin e punës së agjencisë për shërbime audio dhe audiovizuale, të postës dhe agjencisë për komunikime elektronike.



RREZIKOHET PUNA E XEHEROREVE

MINIERAT KUNDËRSHTOJNË LIGJIN PËR LËNDË TË PARA

Shoqata e Maqedonisë së Minierave sërish ka kërkuar që të mos miratohen ndryshimet e Ligjit për lëndë të para minerale me procedurë të shkurtuar. Ambientalistët thonë se ndryshimet e legjislacionit propozohen për shkak të mbrojtjes afatgjatë të ambientit dhe shëndetit të popullatës që jeton në afërsi të minierave



zgjedhurit e popullit të mendohen mirë para se të votojnë ndryshimet ligjore, me qëllim që të mos dëmtohet puna e kësaj dege të rëndësishme ekonomike për shtetin.

“Ndryshimet e ligjit janë të dëmshme, jologjike, selektive, të paqarta dhe të pazbatueshme në praktikë. Ato shtyhen për tu miratuar me procedurë të shpejtë, përkundër faktit se të njëjtat nuk do të zgjidhin asgjë, por përkundrazi edhe më tej do të komplikojnë situatën.” thotë Nikollajço Nikolov, kryetar i Shoqatës së minierave të Maqedonisë.

Sipas tij, nëse me të vërtetë dëshmohej se minierat janë ai fakti që ndot ambientin, ne të parët do të tërhiqemi nga ky ligj.

Nga Shoqata e Minierave të Maqedonisë, kohë më parë kanë hedhur poshtë pretendimet në Propozim-tekstin e ligjit, se ndryshimet ligjore nuk do të kenë pasoja financiare. Sipas përfaqësuesve të industrisë së mineraleve

vetëm nga ndërprerja eventuale e marrëveshjeve për koncesione dëmet do të arrijnë një deri tre miliardë euro. Këtë shumë mund ta paguajë shteti nëse dënohet për shkak të ndërprerjes së njëanshme të marrëveshjes, sipas Ligjit për koncesione dhe partneritet privat dhe publik dhe nenit 45 të këtij ligji.

Propozues të ndryshimit të Ligjit për lëndë të para minerale me procedurë të shkurtuar janë deputetët Liljana Popovska, Meri Lazarova Ivana Tufegxhiq, Ketii Smileska, Goran Milevski, Pavle Bogovski dhe Dime Velkovski.

Një nga propozuesit e ligjit, deputetja Liljana Popovska, njëherësh edhe kryetare e partisë së gjelbër “Dom”, kohë më parë deklaroi se ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për lëndë minerale propozohen për shkak të mbrojtjes afatgjatë të ambientit dhe shëndetit të popullatës që jeton në afër-

si të minierave, si dhe për të penguar zbatimin e teknologjive që përdorin substanca të rrezikshme. Duke pasur parasysh dimensionet e vendit tonë, si dhe faktit se ekosistemi është një tërësi, atëherë mund të thuhet se rreziku ju kano set qytetarëve të gjithë Maqedonisë dhe rajonit më të gjërë, përtej kufijve të Maqedonisë, shton më tej ajo.

Nga DOM thonë se rrezik potencial nga cianidi, ekziston edhe nga afër 80 koncesione të tjera të lëshuara për hulumtime gjeologjike. Pas kësaj mund të priten edhe një numër po aq i madh i koncesioneve të reja për eksploatinimin e lëndëve të para minerale.

Me ndryshimet ligjore do të ndalohet përdorimi i cianidit, acidit sulfurik dhe substancave të tjera të dëmshme gjatë hulumtimeve gjeologjike, përpunimit dhe eksploatinimit të lëndëve të para minerale. Për prodhimin e prodhimeve të gatshme prej mineraleve, tek xehet e caktuara përdoret cianidi dhe acidi sulfurik në sasi të buta të lejuara sipas standardeve botërore.

Në ndërkohë, ambientalistët thonë se përdorimi i cianidit dhe hapja e minierave të reja do të shkaktojë shpërnguljen e numrit të madh të banorëve. Përfaqësuesit e minierave thonë se këto materiale nuk janë të dëmshme për ambientin, përdoren në shumë sektorë si mekanizimi bujqësor, mbrojtjen e bimëve, ndërsa shtojnë se nuk ka dëshmi se dikush është sëmurë nga këto materiale.

Nga ana tjetër, industria e minierës numëron 12.600 të punësuar, ndërsa eksporti arrin 180 milionë dollarë në vit.

Sipas përfaqësuesve të kësaj shoqata deputetët praktikisht do t'i mbyllin të tre minierat për plumb dhe zink, Sasa, Ziletovë i Toranicë. Me ndryshimet kërkohet që të mos përdoret cianid në procesin teknologjik, gjë që sipas përfaqësuesve të sektorit të xehetarisë është procedurë e zakonshme dhe e lejuar edhe në vendet e Bashkimit Evropian.

Edhe nga Sindikata e industrisë, energjetikës dhe minierave kanë kërkuar të tërhiqen propozim ndryshimet e Ligjit për lëndë minerale. Nga atje thonë se nëse nevojitet të përkufizohet përdorimi i disa substancave të rrezikshme për shëndetin e njeriut dhe ambientit, atëherë kjo nevojitet të bëhet sipas normave të njohura botërore dhe në bazë të analizës gjithëpërfshirëse të gjendjes dhe pasojave. Nga Sindikata e minierave shtojnë më tej se në bujqësinë e Maqedonisë përdoren disa herë më shumë cianid se sa në xehetari.

Ndryshe, një shkaqet kryesore të ndryshimeve të këtij ligji, ishin koncesionet e lëshuara për minierat sipërfaqësore të bakrit, Kazandoll në Vallandovë dhe Illova në Bosillovë, të cilat në punën e tyre përdorin sasi të mëdha acidit sulfurik apo të cianidit. Me këtë rast në dy vitet e fundit kishte bujë të madh në tërë vendin, ndërsa u organizuan edhe referendume për ndalimin e punës së minierave.

Koha Fisnik Pasholli

Shkup, 23 korrik - Shoqata e Maqedonisë së Minierave sërish ka përsëritur apelin e saj, për të disa-tën herë pas vitit të ri, që të mos miratohen ndryshimet e Ligjit për lëndë të para minerale me procedurë të shkurtuar. Nga atje kërkojnë që para miratimit të ligjeve të vijojë një debat gjithëpërfshirës me të gjithë palët e interesuara duke filluar nga shteti, komuniteti i biznesit dhe sektori joqeveritar, me qëllim që të dëshmohej se ekzistojnë edhe ndotës të tjerë të ambientit së bashku me minierat. Miratimi i Ligjit pas kalimit në komisionin amë të legjislacionin, gjendet para miratimit nga ana e Kuvendit të Maqedonisë, andaj përfaqësuesit e minierave kanë një lutje deri tek të

“KASTINVEST” HEQ DORË NGA GRANDI NGA FONDI PËR INOVACION

Prokuroria Themelore Publike e Prokurorisë së Krimin të Organizuar më herët njoftoi se ka formuar një lëndë pas njoftimeve në media rreth abuzimeve të mundshme përgjatë keqpërdorimeve të shpërndarjeve së grandeve nga një konkurs publik nga Fondi për Inovacion dhe Zhvillimin Teknologjik

Shkup, 23 korrik - Pati shumë debat për ndarjen e fondeve për inovacion në Maqedoni dhe kjo i ka ra në vesh Prokurorisë Themelore Publike (PTHP) në Maqedoni që tashmë ka vendosur që të hetojë këtë rast.

Në mesin e kompanive që ki-

shin fituar grante ishin edhe kompani ku aksione kanë kryeministri i Qeverisë së Maqedonisë, Koço Angjushev dhe deputeti i LSDM-së, Hari Llokenec, të cilët kanë fituar fond për inovacion me bashkëinvestim prej 10 milionë denarë, apo 160.000 euro.

“Prokuroria ka marrë hapa që të kontrollojë faktet në këtë lëndë për të vlerësuar ndonjë veprimtari kundërvajtëse në konkursin e hapur për financim të projekteve të planit për zhvillim ekonomik – shtylla e tretë” thuhet në njoftimin e PTHP-së.

Për këto fonde, dy zyrtarët e pushtetit, Angjushev dhe Llokenec gjatë ditës së djeshme thanë se do të kërkojnë nga partnerët e kompanive që të heqin dorë nga këto fonde.

Pas kësaj këtij debate, “Kastinvest” heq dorë nga grandin nga Fondi për Inovacion. Nga, ata nëpërmjet në komunikate njoftojnë se kanë vendosur të heqin



dorë nga grandin për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme me rritje të shpejtë (gazelat) të marra nga Fondi i Inovacionit, përcjell Telegrafi Maqedoni.

“Ne duam ta bëjmë të qartë se nuk kemi marrë fonde nga Fondi për Inovacione. Ata u kushtëzuan nga një investim nga ana jonë si një kompani prej 330.000 euro, të cilat duhej të investoheshin brenda një viti, ndërsa mjetet nga Fondi duhej të vinin në faza të realizi-

mit”, thuhet në komunikatë.

Nga atje thonë se kompania i ka plotësuar të tëra kushtet për fitimin e grandit, ndërsa Koço Angjushev është bashkëpronar i “Brako”, ndërsa jo si person i vetëm i kompanisë.

“Plani për pesë vitet e ardhshme është fokusuar për të rritur asortimentet dhe për të zgjeruar kapacitetet prodhuese. Prandaj, kemi aplikuar për grand në Fondacionin për Inovacione. Investimi

i përgjithshëm i projektit është 500.000 euro dhe ka për qëllim blerjen e reja të CNC-makinave, makina bluarje, pajisjet matëse, mjete për ngjyra, duke fituar certifikatat ndërkombëtare të nevojshme për tregjet e huaja dhe certifikata dhe pajisje për të përmbushur ekostandardet. Investimi është planifikuar të dyfishojë numrin e të punësuarve. Ne kemi në plan që 80 për qind e prodhimit të jetë për eksport”, thuhet në komunikatë.

Bordi i drejtorëve të “Kastinvest” do të mblidhet ditët e ardhshme dhe do të vendosë për hapat e tyre të mëtejshëm.

Prokuroria Themelore Publike e Prokurorisë së Krimin të Organizuar më herët njoftoi se ka formuar një lëndë pas njoftimeve në media rreth abuzimeve të mundshme përgjatë keqpërdorimeve të shpërndarjeve së grandeve nga një konkurs publik nga Fondi për Inovacion dhe Zhvillimin Teknologjik.

Shënimi i 55 vjetori të tërmetit katastrofal të Shkupit, ITKSH ka vendosur ta shënojë me prezantimin e aktiviteteve dhe ndihmën që shteti Amerikan ua kishte ofruar shkupjanëve. Mëngjesi i kobshëm i 26 korriku i vitit 1963, ndonëse i takon të kaluarës, ai vazhdon të qëndroi i freskët në kujtesën e shumë banorëve të Shkupit dhe aktivistëve që kanë marrë pjesën në dhënien e ndihmave

EKSPOZITË PËR 55 VJETORIN E TËRMETIT NË SHKUP

ITKSH PËRKUJTON NDIHMËN AMERIKANE



FIGURE 17.—Members of the 8th Evacuation Hospital in Skopje, Yugoslavia, following the earthquake in 1963. The unit was flown to the disaster site to provide medical care to the victims. (U.S. Army photograph.)

Dokumentet që pritet të prezantohen në këtë ekspozitë, siç shprehet drejtori Asani, janë siguruar pas një hulumtimi në Arkivin e Qytetit të Shkupit, përfshi institucionet dhe arkivet tjera botërore. Po ashtu në këtë ekspozitë opinionin do të ketë mundësi të shoh pjesë nga shtypi i Jugosllavisë së atëhershme, ku është raportuar për ndihmat amerikane në periudhën pas tërmetit të vitit 1963, gjegjësisht të dhëna nga shtypi Amerikan i asaj kohë që flet për Shkupit dhe pasojat e tërmetit.

“Ndhima e shtetit Amerikan asokohe është mbështetur në tre elemente, gjegjësisht në ndërtimin e lagjeve për banim, vendosjen e studentëve dhe ofrimin e ndihmës mjekësore. Vlen të theksohet se ekipet amerikane që kanë dhënë ndihma në Shkup, gjatë asaj periudhe kanë arritur para atyre të ushtrisë Jugosllave. Rrugëtimi i tyre drejt Shkupit kishte filluar nga Gjermania, me ushtria kishte zbarkuar në aeroportin e Beogradit dhe Zagrebit. Kësisoj përmes trenit dhe mjeteve

tjera transportuese ato nisen drejt Shkupit. Me tu futur në Maqedoni, ushtria amerikane aktivitetin e tyre humanitar e përqendron në tre segmente. Vendosija e popullatës nëpër objekte banimi ka qenë qëllimi primari ushtrisë Amerikane. Për këtë arsye ato kanë vendosur që me mjettet e tyre ta ndërtojnë në lagje të re të përkohshme banimi, e cila sot njihet si lagja e Shuto Orizares. Realizimi i punimeve për ngritjen e barakave apo shtëpizave të përkohshme është realizuar gjatë periudhës vjetor 1963-64. Tutje, amerikanët me kontributin e tyre e kanë ndërtuar lagjen e Studentëve, e cila gjendet poshtë pjesës lindore të Malit të Gazi Babës. Dhe sfera e tretë ku ushtria amerikane, me urdhër të kryetari të atëhershëm Xhon Kenedi, e ka ndihmuar Shkupin, pas tërmetit ka qenë ndërtimi i një kompleksi shëndetësor. Ky spital fushor i përkohshëm ka funksionuar në pjesën mes Shkupit dhe Kumanovës, në të cilën janë transferuar një numër i konsiderueshëm i qytetarëve që janë lën-

duar nga tronditjet e tërmetit”, thotë Asani, për gazetën KOHA.

Sipas shtypit të atëhershëm numri më i madh i shtetasve të huaj mëngjesin e kobshëm të 26 korriku, 55 vite më parë kishin qenë të vendosur në hotel “Makedonija”, (sot objekti mbi Kafe Trend) në Shkup. Përveç të punësuarve që kishin humbur jetën, nën rrënojat e hotel “Makedonija”, shërbimet e asokohe kishin zbuluar trupat e shumë shtetasve Bullgar dhe Belg, përfshi shtetasen Amerikane, Nensi Hamilton. Po ashtu në listën e shtetasve të huaj që kishin humbur jetën në qendër të Shkupit, thuhet se ka pasur dhe disa shtetas të Francës, Gjermanisë e Austrisë.

Krahas ITKSHS-së, brenda kësaj jave një varg institucioneve shtetërore në agjendat e tyre kanë paraparë shënimin e datës të 26 korriku dhe përkujtimin të mbi 1000 viktimave dhe dëmeve të hatashme që kishin ndodhur pas dridhjeve të mëdha që kishin kapluar tokën e Shkupit.

Ulen kompetencimet për deputetët

Deputetët në Maqedoni do të marrin kompensim më të ulët për harxhimet e rrugës, pasi të hënën në Kuvend me 76 vota “pro” dhe një “të përmbajtur” u votuan ndryshimet në Ligjin për deputetët.

Me këto ndryshime në vend të 30 për qind për çdo kilometër të kaluar nga çmimi i naftës për një litër, deputetët do të marrin 20 për qind për kilometrat që kalojnë për të ardhur në punë. Sipas ndryshimeve, deputetëve ju mundësohet edhe shpajm për blerjen e banesave në Shkup. Konkretisht, deputetët që jetojnë nga 100 kilometra larg Kuvendit, ju ngelet mundësia për blerje të banesës, me të drejtë vetëm për katër udhëtime në muaj.

Para votimit deputetja e VMRO-DPMNE-së, Liljana Zaturaska, tha se edhe me këto ndryshime është keqpërdorur flamuri evropian, por shtoi se deputetët grupit parlamentar të OBRM-PDUKM-së do të mbështesin këto ndryshime.

Koha Omer XHAFFERI

Shkup, 23 korrik - “Amerika për Shkupin”, është titulluar ekspozita e cila pritet të mbahet me 26 korrik në Shkup, me rastin e 55 vjetori të tërmetit katastrofal që e kishte goditur kryeqendrën e Maqedonisë. Nën patronatin e Institutit të Trashëgimisë Kulturore dhe Shpirtërore të Shqiptarëve-Shkup, të enjten do të shënohet data e kobshme e 26 korriku dhe njëkohësisht do të prezantohet materiale ekskluzive që deri më tani nuk kanë qenë të njohur për opinionin. Kryetari i ITKSHS-Shkup, Skender Asani, duke folur për këtë ngjarje të rëndësishme për shkupjanët, thekson se dokumentet dhe fotografitë që do të prezantohen edhe më tepër do ta bëjnë ta bëjnë të qartë ndihmën që ndër vite shteti Amerikan e jep për Maqedoninë dhe Shkupin.

Çmime të reja të derivateve të naftës, lirohet dizeli

Shkup, 23 korrik - Benzina dhe vaji ekstra i lehtë për amvisëri nga mesnata e sotme do të shiten për një denarë më lirë, ndërsa dizeli do të jetë një denarë e gjysmë më i lirë. Me vendim të Komisionit Rregullator për Energjetikë, çmimi i ri i Eurosper BS 95 do të jetë 71 denarë, Eurosper BS-98 do të jetë 73 denarë, ndërsa vaji ekstra i lehtë do të jetë 51.5 denarë për litër. Kurse çmimi i Eurodisel do të jetë 62.5 denarë.

Çmimi me pakicë i mazutit do të ulet për 0.81 denarë për kilogram dhe do të shitet për 33.897 denarë. KRRE vendimin për ndryshimin e derivateve të naftës e ka sjellur në bazë të çmimit të mesatar të naftës në tregun botëror.

KONFERENCË GLOBALE KUNDËR SIDË-s

PËR 30 VJET 83 PERSONA KANË VDEKUR NË MAQEDONI

Shkup, 23 korrik - Mijëra shkencëtarë, aktivistë dhe politikanë mblidhen sot në Amsterdam për një konferencë katër ditëshe për epideminë globale të HIV/AIDS-it. Qëllimi i tubimit të këtij viti është të diskutohen mënyrat për të edukuar dhe trajtuar më efektivisht popullatat më në rrezik. Kombet e Bashkuara, së voni, kanë paralajmëruar se numri i infektiveve të reja po rritet në shumë vende, veçanërisht në Evropën Lindore dhe Azi. Rreth 37 milionë njerëz jetojnë me infeksionin në mbarë botën, shumica e tyre në Afrikë. Rreth 1 milion njerëz në vit vdesin nga sëmundjet e lidhura me AIDS-in. Në Maqedoni vetëm gjatë muajit mars të këtij viti janë paraqitur tetë raste të reja me këtë infeksion, njofton Instituti për shëndet publik (ISHP). Personat e infektuar janë të gjinisë mashkullore, prej tyre pesë janë të moshës 20 deri 29 vjeç, ndërsa të tjerët prej

30 deri 39 si dhe një është i moshës 40 deri 49 vjet. Në fillim të këtij viti, Ministria e Shëndetësisë së Maqedonisë tha se do të mbështes financiarisht me 1 milion e gjysmë euro “Programin për mbrojtjen e popullatës nga HIV për vitin 2018”, edhe atë për terapi të vazhdueshme anti-retrovirusale për pacientët të cilët jetojnë me HIV, por edhe për parandalim nga HIV-i.

Vitin e kaluar (2017) ISHP ka regjistruar 39 raste të paraqitura të HIV-it në vitin 2017. Numri më

i madh i tyre është nga Shkupi, deri në moshën deri 30-vjeçare. Vitin e kaluar në Maqedoni, nuk është regjistruar asnjë rast me vdekje të personave si pasojë nga komplikimet lidhur me SIDA-n.

Në periudhën prej vitit 1987 deri në vitin 2017, nga numri i përgjithshëm i rasteve të regjistruara me infeksionin HIV është 338, derisa numri i personave të vdekur që si shkak kanë pasur lidhshmërinë me SIDË-n, është 83. Pjesa më e madhe e infektiveve ka ndodhur nëpërmjet

marrëdhënive të pambrojtura seksuale. Në këtë moment, në Shtëpinë e shëndetit publik në Klinikën Universitare për sëmundje infektive dhe gjendje febrile me terapi antiretrovirale mjekohen 190 pacientë, thonë nga Asociacioni HERA.

Ndryshe, në mesin e pjesëmarrësve në Konferencën Ndërkombëtare AIDS 2018 janë princi britanik Harry, këngëtari britanik, Elton John, dhe ish-presidenti amerikan, Bill Clinton.

(AXH)

Tetova, që nga viti 1990 është kthyer në një qendër në Maqedoninë Perendimore, si në aspektin tregtar poashtu edhe në aspekte të tjera, ngase pas hapjes së dy universiteteve dukshëm qyteti është zgjeruar, numri i banorëve është rritur, ndërsa gjithnjë e më pak ka hapësira të gjelbërta

Koha Urim HASIPI

Tetovë, 23 korrik - Komuna e Tetovës me shpërndarjen e të punësuarve nga administrata në ndërmarrjet publike do të tentojë të gjidh problemin me mungesën e kuadrit e cila sipas informacioneve është një nga shkaktarët për mungesën e higjienës dhe mbajtjes së gjelbërimit në qytet. Kryetarja e komunës së Tetovës Teuta Arifi disa herë ka theksuar se ka mungesë edhe të punësuarve në ndërmarrjen parqet dhe gjelbërimi, sepse një numër shumë i vogël i puntorëve, kujdesen për një qytet ku gravitojnë rreth 100 mijë qytetarë. Ajo ka nënvizuar se ky proces duhet të fillojë me shpërndarjen e administratës nëpër ndërmarrje publike por pa precizuar se kur do të fillojë ky proces. Tetova kësajsoj ngel pa hapësira të gjelbërta viteve të fun-

GJITHNJË E MË PAK GJELBËRIME NË TETOVË

KUR PARQET SHNDËRROHEN NË BETON

dit. Të njejtat shkaërrohen në mënyrë të pamëshirshme. Një nga parqet më të gjata përgjatë rrugës Boris Kidriç duke filluar nga Qendra për Kulturë deri tek Qendra Sportive, tashmë veteve të fundit është përfshirë nga ndërtimet dhe zaptimet e tavernave. Një pjesë tashmë është rregulluar si parking ndërsa përgjatë rrugës janë vendosur edhe mburroja prej metali për ndërtimet që zhvillohen. Qytetarët theksojnë se me ndërtimet e reja në qytet dëmtohen hapësirat e gjelbërta të cilët përvetësohen nga investitorë duke mos lënë asnjë hapësirë të gjelbërt apo parqe. Në Tetovë dëmtime të këtilla ka gjithandej sidomos në pjesët ku janë ndërtuar ndërtesa të mëdha. Kjo edhe viteve të kaluara sipas ekspertëve ishte një ndër arsyt kryesore të ndotjes për shkak të mos qarkullimit të ajrit. Nga komuna e Tetovës thonë se hapësirat e gjelbërta do tu kthehen qytetarëve. "NPK Tetova-Tetovë, do të del në teren, do të inspektojë dëmtimet dhe në bashkëpunim me investitorët të cilët ndërtojnë në atë pjesë do të kthehen hapësirat e gjelbërta. Në Tetovë kemi diku rreth 41.123 metër katror sipërfa-



qe të gjelbra publike, por po ballafaqohemi me një problem, në të gjithë jemi të vetëdijshëm se uzurpohen në mënyrë të paskrupullt hapësirat publike mirëpo, tendenca jonë edhe si komunë edhe si ndërmarrje është që ata sipërfaqe të ç'bllokojmë dhe ti kthejmë tek qytetarët", thonë nga pushteti

zuar nga qytetarët, kurse kohëve të fundit ka mbetur vetëm ai pranë Xhamisë së larme, ndërsa së fundi është rregulluar edhe parku afër stacionit të autobusave. Qyteti i Tetovës ndër vite po i humb edhe ato pak hapësira të gjelbërta që i ka. Pjesa dërmuese e hapësirave të lira të cilët kanë qenë me gjelbërim janë uzurpuar dhe në ato vende janë bërë ndërtime. Nga NPK-ja krahas kësaj thonë se për më shumë pastërti vendosin edhe shporta por ato dëmtohen. "Shpesh herë kalimtarë të rastit dëmtojnë shportat dhe të njejtat mund të them se janë në gjendje të mjerueshme. Prandaj në këtë drejtim duhet edhe një vetëdije më e lartë e qytetarëve që të mos i dëmtojnë ata sepse bashkërisht mund të kontribuojmë për një ambient më të pastër në qytetin e Tetovës", thonë nga kjo ndërmarrje. Tetova, që nga viti 1990 është kthyer në një qendër në Maqedoninë Perendimore, si në aspektin tregtar poashtu edhe në aspekte të tjera, ngase pas hapjes së dy universiteteve dukshëm qyteti është zgjeruar, numri i banorëve është rritur, ndërsa gjithnjë e më pak ka hapësira të gjelbërta.

Gjermania lehtëson procedurata punësimit

Ministri gjerman i Punës, Hubertus Heil, kërkon për degë të caktuara të ekonomisë të krijojë lehtësira në kërkimin e punës për fuqinë punëtore nga jashtë.

Në gazetën gjermane "Frankfurter Allgemeinen Sonntagszeitung", ai foli për një vizë të kufizuar në kohë për degë punë si infermiera në azilet e pleqve, ku ka një mungesë të theksuar të fuqisë punëtore. Kjo vizë me kufizim mund t'u mundësojë atyre të kërkojnë drejtpërdrejt punë në Gjermani, tha ministri gjerman. Në këtë procedurë nuk përfshihet marrja e kontributeve sociale.

"Mund të përfytyroj, që fuqi punëtore nga jashtë të vij për një gjysëm viti në Gjermani dhe të kërkojë punë këtu", tha Heil.

"Nëse nuk ia dalin dot të gjejnë punë, atëherë ata duhet të kthehen sërish në vendin e tyre pas përfundimit të afatit.

"Synimi është të kemi sa më pak procese burokratike", për ata

që kërkojnë punë.

Me kërkesë të socialdemokratëve, koalicioni me bazë të gjerë në Gjermani synon që deri në fund të këtij viti të nxjerrë një ligj, që rirregullon ardhjen e fuqisë së huaj punëtore të kërkuar nga ekonomia. Kjo do të lehtësojë mundësitë e punësimit për jo-akademikët. Me këtë synohet të reduktohet edhe migracioni ilegal.

Kancelarja Angela Merkel në konferencën e shtypit para pushimeve të verës e quajti këtë "një projekt qendror" të qeverisë. Edhe ministri i Brendshëm, Horst Seehofer ka paralajmëruar për një vjeshtë paraqitjen e një plani orientues.

Ideja e lejes së së kufizuar të qëndrimit për fuqi të huaj punëtore pa arsim të lartë mbështetet edhe nga ekonomia gjermane.

Sipas revistës "Spiegel", ajo është pjesë një plani shtatë pikësh të Shoqatave Federale Gjermane të Punëdhënësve, (BDA).

ITSHKSH ME PROGRAM TË RI STUDIMOR

Studimet e ciklit të dytë për Kulturologji

Shkup, 23 korrik - Kulturologjia është programi i ri studimor i ciklit të dytë të studimeve në Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore dhe kulturore të shqiptarëve të Maqedonisë (ITSHKSHM), kështu tha për Gazetën Koha, drejtori i Institutit, Skender Asani.

Ideja për këtë program studimor erdh si mungesë e kuadrove deficitar shqiptar të kësaj lëmie, tha më tej Asani.

"Ne po startojmë këtë vit akademik edhe me një program të ri është kulturologjia. Program interdisciplinar i munguar për shqiptarët këtu sepse në këto sfera ne kemi mangësi të mëdha të kuadrin profesional për ti edukuar dhe për ti profesionalizuar që ata pastaj ta bartin në institucionet e ndryshme të kulturës, mediave dhe sferave të ndryshme dhe të ngrisim nivelin qytetar dhe shkenor këtu në Maqedoni", u shpreh Asani.

Në këtë drejtim ka vende të lira për 30 studentë, ndërsa çmimi për një vit akademik do të përcaktohet sipas kushteve që do ti përcaktojë Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH).



"Ne kemi paraparë të pranojmë 30 studentë, reagimet e para janë shumë pozitive dhe shpresëdhënëse, dhe besoj që nuk do të jenë studentë vetëm nga Maqedonia, ka interes edhe të studentëve nga Kosova dhe Shqipëria. Ligjërues kemi nga universitetet e ndryshme por e plotësojmë edhe kriterin e brendshëm të Institutit, aty ku na mungojnë kuadrot profesional ne veç

më i kemi kontaktuar dhe kanë pranuar që të jenë studiues të mirëfilltë të lëndëve përkatëse. Çmimet do ti përcaktojme sipas normave të MASH dhe besoj se së shpejti do të dalim edhe aspektet e qarta financiare të këtyre studimeve", sqaron Asani.

Për momentin në ITSHKSHM ekzistojnë dy programe studimore të ciklit të dytë edhe atë gjuhë dhe letërsi dhe marrëdhënie ndërkombëtare, secili program ka maksimum 30 studentë. (A.Xh)

NISMË PËR LIRIMIN E HAPËSIRAVE PUBLIKE

TË MERR FUND UZURPIMI

Trotuaret dhe gjelbërimi përskaj rrugëve kryesore në Çair, vite me radhë qëndrojnë të uzurpuara. Si rezultat i këtij kaosi shumë qytetarë nuk mund të qarkullojnë lirshëm. Përmes reagimeve të ndryshme, kryesisht nëpërmjet rrjeteve sociale, ata i bëjnë thirrje Komunës së Çairit, që aksionet për lirim e hapësirë publike t'i konkretizoj me rrënimin e objekteve të ndërtimit të fortë



pretekst se komuna nuk po ndërmer masa të gjithanshme për largimin e uzurpimeve kryesore. Largimi i rrethojave të drurit dhe atyre të metalit, përfshi edhe rrënimin e një kulmi banesor, janë vetëm një pjesë e aktiviteteve që shërbitmet përkatëse të Komunës së Çairit i kanë realizuar javëve të fundit.

MUNGESA E KONTROLLIT INSTITUCIONALE

Edhe pse me territori e vogël, hapësira publike e Çairit si komunë, vite me radhë është keqpërdorur, dëmtuar e uzurpuar në mënyra të ndryshme. Mungesa e kontrollit institucionale dhe toleri-

mi i organeve komunale në ndërtimin vend e pa vene, paraqet një rëndësi prej shkaqeve kryesore në pjesën e vjetër të Shkupit të mbizotërojnë një kaos i vërtet. Nga lagja e Sahat Kullës e deri në Seravë, ose nga Gazi Baba e deri në lagjen e Dyqanxhikut, duke mos i përjashtuar rrugët kryesore dhe bulevardet, mund të vërehen me qindra hapësira dhe parqe të uzurpuara. Gjendja aktuale me kaosin urban në Çair, sipas shumë qytetarëve të vjetër nuk ka ekzistuar çdoherë. Nëse deri në vitin 2005, qytetari shqiptar i Shkupi ka hasur në vështirësi të mëdha për marrjen e lejes për ndërtim apo zgjerim të objekteve përkatëse, kryesisht shtëpi-

të banimit, ai përgjatë 15 viteve të kaluara, duke u mbështetur në "vullnetin e mirë" të organeve komunale nuk ka përfillur asnjë leje apo urdhër të autoriteteve lokale.

Përveç në brendësi të lagjeve të theksuara, kaosi dhe uzurpimet e hapësirës publike në Çair kanë ndodhur edhe përgjatë bulevardëve (nëse mund të cilësohen si të tilla). Rrugët si ajo e "Cvetan Dimovit" apo "Pllastikave", përfshi edhe atë të "Xhon Kenedit", gjegjësisht "Bit Pazarit", janë pasqyra më reale se në çfarë gjendje jetojnë banorët e kësaj ane të kryeqendrës. Trotuaret e zaptuara dhe dëmtimi i drunjëve dhe asaj pjesë të vogël të gjelbëruara përgjatë

këtyre rrugëve ndër viteve nuk është parandaluar.

AKSIONE KUNDËR UZURPIMEVE

Autoritet e Komunës së Çairit, në një prononcim zyrtar për gazetën KOHA, njoftojnë se aksionet për lirim e hapësirave publike të uzurpuara do të vazhdojnë tutje, duke theksuar se veprimet e ardhshme do të ndërmerren në bashkëpunim me Qytetin e Shkupit.

"Lidhur me lirim e hapësirave publike përgjatë bulevardëve të cilat në bazë të ligjit janë kompetencë e Qytetit të Shkupit, ju njoftojmë se jemi në koordinim e sipër me institucionin e lartë përmendura për veprimet e mëtutjeshme. Me iniciativë të Qytetit të Shkupit janë duke u përgatitur ndryshime në Rregullore me çka edhe do të fillohet me lirim e hapësirave publike nëpër bulevardet e apostrofuara. Pas konsolidimit të Rregullores dhe miratimit e konkluzioneve do të ndërmerren masa të mirë koordinuara edhe për çështjen e lirim të bulevardëve", thonë nga Komuna e Çairit.

Kontribut të hatashëm në përkeqësimin e jetesës së banorëve të Çairit, pa dyshim ka dhënë edhe Ligji për legalizimin e objekteve të ndërtuara pa leje. Mosrespektimi i mirëfilltë i dispozitave që burojnë nga ky ligj, qoftë nga organet shtetërore apo vetë qytetarët, ka ndikuar që përveç Çairit, kaosi urban të shtrihet edhe në pjesën qendror të Shkupit.

Koha Omer XHAFFERI

Shkup, 22 korrik - Inspektorati i Komunës së Çairit, kohëve të fundit ka realizuar disa aksione për lirim e hapësirave publike. Përderisa një pjesë e qytetarëve i kanë mirëpritur këto aktivitete të Komunës së Çairit, një pjesë tjetër kanë shprehur revoltën e tyre, me

PERIPECITË E BIRËSIMIT

Benjamin Perks, përfaqësues i UNICEF-it në Maqedoni thotë që ka për qëllim deri më 2020 të mos ketë asnjë fëmijë, që nga lindja deri në tre vjeç, që jeton në institucione sociale, me qëllim që këta fëmijë të kenë dashuri prindërore dhe përkujdesje më të madhe

Koha Delvina KËRLUKU

Shkup, 23 korrik - Individët, çiftet, familjet, të cilët duan të përkujdesen për një fëmijë jetim, të braktisur, fëmijë me nevoja të veçanta, shteti u mundëson një gjë të tillë.

Varfënjakët duan fëmijë, por s'kanë kushte

Birësimi i një fëmije gjithsesi duhet të përmbush disa kriteret. Mirëpo, një çift ka kërkuar që të birësojë një fëmijë, që para 13 viteve për shkak se martesë e tyre nuk ka sjellë trashëgimtar. Vasfiu, i cili sot është 57 vjeç, flet për gazetën "Koha" me nostalgji, për dëshirën e madhe për të pasur një fëmijë, më saktë një djalë. Ai thotë se tashmë kanë kaluar 17 vite nga ëndrra për të pasur në shtëpinë e tyre një fëmijë, i cili do të bëhej pasardhësi i tyre. Pesë vjet kanë vrapuar nëpër institucione dhe përherë kanë marrë me vete shpresën nga premimet që u janë dhënë nga përgjegjësit. Ata si fillim kanë kërkuar djalë e jo vajzë, por përgjigja për një djalë ka qenë gjithmonë negative. Edhe pse kanë qenë shëndet plotë, me një shtëpi me plita, por e mbajtur mirë nga dora e gruas, e cila sot është 48 vjeçare. Shtëpi kjo e trashëguar

nga të parët e tij. Vasfiu thotë se inspektorati nga qendra sociale, për gjendjen ekonomike, shëndetësore, i kanë vizituar dhe kanë konstatuar se çdo gjë është në rregull. Ai sot është skeptik nëse në moshën që ka mund të rrit një fëmijë, por ëndrra nuk shuhet. Vasfiu pyet se pse ata që duan të birësojnë një fëmijë, nëse është problem gjendja ekonomike, nuk u ndihmon shteti financiarisht, ndërsa në anën tjetër bëjnë apel që fëmijët jetim të mos lihen pa dashuri prindërore? Linja e telefonit 15133 (pa pagesë), është hapur nga qendrat sociale dhe jep informacione për njerëzit e interesuar të marrin një fëmijë nga shtëpitë e jetimëve. Përgjegjësit e kësaj linje për gazetën "Koha", thonë se kjo linjë punon nga ora 8 e mëngjesit deri më 20h. Dhe se kriteret të cilat janë dhe që duhet të përmbush i interesuari është që individi të jetë

i moshës nga 18 vjet në 65 vjet. Të jetë shëndetplotë, ekonomikisht mire, të ketë vërtetim nga gjykatat, se nuk ka qenë i dënuar, për ndonjë vepër kriminale. Ata shpesh thonë se Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, ka komisionin e vet që del në terren dhe hulumton personin që është interesuar të birësojë një fëmijë, nëse ka gjendje të mirë ekonomike dhe një shtëpi për jetesë. Nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, për gazetën "Koha" thonë se rregullorja në bazë të së cilës zgjedhja e prindit adoptues bëhet në mënyrë elektronike, dhe duhet të ketë personi gjendje të mirë shëndetësore; statusin psikosocial; kushtet materiale; kushtet e banimit; koha e pritjes; shkalla e arsimit; statusi dhe shtetësia. Për secilën prej këtyre kriterëve përcaktohet numri i pikave të dhëna në rregulloren dhe numri maksimal i pikëve që mund të

arrihen duke përmbushur të gjitha kriteret është 100 pikë, thonë nga MPPS. Psikologja Zorica Gjorgjieva thotë se shumë institucione, siç janë shtëpitë e fëmijëve pa përkujdesje prindërore, sa do që të kenë kushte dhe sa do që të kenë personel mbikëqyrës, asnjëherë nuk mund të zëvendësojë dashurinë dhe përkrahjen e familjes dhe rrethit të saj. Fëmija vetëm në mjedisin familjar mund të ndjej dashurinë, mbështetje dhe përparësi. Për këtë MPPS në bashkëpunim me UNICEF-in kanë ngritur kampanjën "për çdo fëmijë nevojitet familje". Benjamin Perks, përfaqësues i UNICEF-it në Maqedoni, iniciator i fushatës thotë që ka për qëllim deri më 2020 të mos ketë asnjë fëmijë, që nga lindja deri në tre vjeç, që jeton në institucione sociale, me qëllim që këta fëmijë të kenë dashuri prindërore dhe përkujdesje më të madhe.

Aleanca Kosovare e Bizneseve ka zhvilluar një studim hulumtues në Kosovë ku në theks të veçantë ka pas investitorët e huaj e sidomos mes atyre që vinë te vizitojnë Kosovën për mundësinë e investimeve dhe atyre që ikën dhe ndalën për të investuar në vendin tonë.

Agim Shahini, Kryetar i AKB-së tha se një studim i tillë u zhvillua për herë të parë në Kosovë dhe AKB është e kënaqur që arriti të realizoj këtë projekt me sukses por është e shqetësuar me të gjeturat e këtij studimi hulumtues.

“Nga viti në vit ka pas përmirësime të dukshme në politika fiskale por jo të mjaftueshme dhe kjo me së miri dëshmohej me të gjeturat e këtij studimi për te cilat investitorët kanë paraqit vërejtjet e tyre në aspekt legjislativ dhe jo legjislativ. Si do që të jetë se a me shumë kanë të drejtë investitorët që ankohen apo institucione e vendit që lavdërohen një gjë është e sigurt se Kosova ka pak investitorë të huaj, pak brende të njohura e me pak korporata të huaja të fuqishme që përmirëson imazhin tonë të gjitha fushat ekonomike, politike kulturore e sportive”, thuhet në njoftimin e tyre, tyranmseton Gazeta Observer.

Njoftimi i plotë i hulumtimit të tyre:

Kosova ka shumë pasuri natyrore e potenciale humane individuale dhe politik e që këto dy të para nuk mund të ecin me hapa të përshpejtuar nëse nuk kanë mbështetje apo interes politik gjë që kjo paraqitet si pengesë edhe për ecje drejt finalizimit të arritjes së suksesit investiv.

MBI 94% TË INVESTITORËVE TË HUAJ KANE IKUR NGA KOSOVA



Nga viti 2016/17/18 Kosova është duke u përball me probleme politike siç janë Demarkacioni, Liberalizimi i Vizave, Ushtria e Kosovës, Asociacioni i Komunave serbe dhe Dialogu i drejt për drejt me Serbin duke mos i përmend problemet e brendshme të politikës që gjithë këto e kanë lënë ekonominë si problem sekondar a në fakt problemi primar është zhvillimi ekonomik i vendit.

Gjithë kjo ka bërë që investitorët e huaj të vinë në Kosovë më shumë si turistë se sa si investitor kurse ne kemi nevojë për te gjithë por jo investitorët të vinë njëherë e të ikën e mos të vinë më as si vizitor apo turistë.

Vitin e kaluar nga të gjithë ata që kanë ardhur për të vizituar Kosovën për mundësi të investimeve

vetëm 2% kanë mbet këtu, 4% janë duke i shqyrtuar mundësin kurse 94% janë deklaruar që nuk vinë në Kosovë apo kanë gjetë mundësi më të mira në vendet tjera.

Deklarimet e tyre pse nuk vinë në Kosovë janë të ndryshme por paraqiten në 10 pengesa:

Nuk ka siguri për investime, Mungon mbështetja institucionale e parimeve biznesore, Burokracia dhe korrupsioni administrativ, Kyçja në infrastrukturën fizike të shtrenjta, Lejet për ndërtim që zvarritet e tyre një e më shumë vite me korrupsion, Ngarkesat fiskale të menjëhershme dhe jo të lira, Mbështetja financiare e shtrenjtë, Mos gjetja e partnerëve vendor të besueshëm, Tregu i vogël, Parcela për të blerë të shtrenjta.

PO, ku kane shkuar këta investitor ata deklarohen ne Serbi 35%, Maqedoni 25% Shqipëri 15% Male të zi 10% BiH 5% kurse rreth 10% nuk janë deklaruar.

Të gjitha këto tash nuk janë më problem vetëm për investitorët e huaj por edhe atë të vendit ku disa nga këta po dalin jashtë për të zgjeruar aktivitete e tyre dhe mundësitë më të lira për investim.

Suat Berisha, Nënkryetarë i AKB-së tha se Kosova ka disa ligje të mira por jo të zbatueshme duke u referuar në Ligji për Investime Strategjike i cili Kosovës deri tash nuk i ka sjell asgjë dhe si pasojë e saj shumë investitor siç u cekën me lart kanë ikur në vende të tjera të regjionit.

Ndërsa Bashkim Osmani, Nënkryetarë i AKB-së tha se Kosova duhet të ndryshoj qasjen ndaj të gjithë investitorëve dhe gjej mënyra ti josh ata për ndryshe gjërat mund të keqësohen edhe më shumë kurse mundësitë janë që Kosova të jetë Lider në Ballkan sepse disa vende të regjionit po ofrojnë subvencione për punëtorë e rinj deri në tri vite.



Maqedoni, mbështetje financiare për ujitje

Duke filluar nga 21 korriku e deri më 21 gusht bujqit në Maqedoni do të mund të aplikojnë për marrjen e mbështetjes financiare nga Programi për zhvillim rural përmes masës qeveritare që mban emrin "Furnizimi i sistemit për ujitje pikë për pikë, konstruktiv dhe ndërhyrje të tjera të ujit sipërfaqësor".

Me këtë masë, siç informojnë nga Agjencia për mbështetje financiare të bujqësisë dhe zhvillimit rural, në disponim janë 20 milionë denarë, ndërkaq me këto mjete ekonomitë bujqësore do të mund të pajisen me sistem për ujitje pikë për pikë, të bëjnë kontruktimin e bunarëve dhe ndërhyrje të tjera të ujit sipërfaqësor.

Drejtori i Agjencisë për mbështetje financiare të bujqësisë dhe zhvillimit rural, Nikollçe Babovski, thotë se për masat do të mund të aplikojnë të gjithë bujqit të cilët janë evidentuar në regjistrin e vetëm të ekonomive bujqësore.

Të gjithë të interesuarit me këto mjete mund të pajisen me sisteme nëntokësore për ujitje pikë për pikë, pajisje dhe mjete bashkangjitime për sistemin për ujitje (filtra, fertirigatore, pompa, gypa dhe elemente lidhëse), pajisje dhe mekanizëm lidhës për vendosje dhe grumbullim të sistemit pikë për pikë, pajisje për instalacion elektrik për furnizim me energji elektrike, prëfshirë edhe pajisje për efikasitet energjetik dhe pajisje për prodhim të energjive të qendrueshme dhe agregatë apo gjeneratorë dhe pajisje shoqëruese të instalacionit.

Shteti që po rrezikon Amerikën si fuqi ekonomike

Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA) kanë ekonominë më të madhe në botë me 20.4 trilion dollarë, sipas të dhënave të Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN), që tregon se ekonomia amerikane pati rritje vitin e kaluar nga 19.4 trilion dollarë, në 20.4 trilion dollarë.

Kina e ndjek me 14 trilion dollarë, që është një rritje prej më shumë se 2 trilion dollarë në krahasim me 2017. Japonia është në vendin e

tretë me një ekonomi prej 5.1 trilion dollarësh, nga 4.87 trilion dollarë një vit më parë.

Megjithatë, kështu siç po ecin gjërat, sipas "World Economic Forum", dominimi i ekonomisë amerikane do të pësoi rënie. Dhe ajo që mund t'ia zë vendin është Kina. Sipas të dhënave të Bankës Botërore, ekonomia globale do të zgjerohet me 6.5 trilionë dollarë midis 2017 dhe 2019. GDP e Amerikës pritet të



përbëjë 17.9 % të kësaj rritjeje. Kina, megjithatë, parashikohet të arrijë pothuajse dyfishin e kësaj, përkatësisht 35.2 %./Kosova-Press/

KOSOVA NUK PLANIFIKON HEQJEN E DOGANËS PËR MAQEDONINË

Nga Ministria e Bujqësisë shprehen se ende janë duke u zhvilluar bisedimet me autoritetet në Prishtinë. Do të pritet epilogu nga mbledhja e së mërkurës e vendeve anëtare të CEFTA-s, ku do të kërkohet nga Kosova që ta tërheqë masën.



Kosova të dalë nga marrëveshja e CEFTA-s. Kjo është një prej kundërmasave që do ta kërkojnë autoritetet serbe në takimin e vendeve të rajonit që do të mbahet të mërkurën. Kjo vijon pasi Kosova vendosi dogana shtesë prej 30% për

importin e rreth 20 produkteve bujqësore. Ministri serb i tregtisë dhe turizmit, Rasim Lajiq pohon se nuk pret që Prishtina ta tërheq këtë barrierë jashtë doganore që vlen për të gjitha shtetet ndërsa dëmin më të madh e pësojnë Maqedonia dhe Bosnja e Hercegovina. Kuptohet,

presioni jonë ndaj Komisionit Evropian do të jetë permanent pasi sjellja e këtillë duhet të ndërpritet ose Prishtina të dalë formalisht nga marrëveshja e CEFTA-s. Mendoj se kjo nuk është korrekte pasi në këtë mënyrë i shfrytëzojnë dobitë, ndërsa kur t'ju kujtohet, vendosin barri-

ra jashtë doganore ndaj partnerëve -deklaroj Rasim Lajiq, ministër i tregtisë dhe turizmit, Serbi.

Nga Ministria e Bujqësisë shprehen se ende janë duke u zhvilluar bisedimet me autoritetet në Prishtinë. Do të pritet epilogu nga mbledhja e së mërkurës e vendeve anëtare të CEFTA-s, ku do të kërkohet nga Kosova që ta tërheqë masën. Nëse nuk ndodhë kjo, Maqedonia do të miratojë masa për mbrojtjen e prodhimit të vendore. Ministria e Bujqësisë deklaroi se: "Qeveria bën çmos që të mos vjen deri te situata që të vendosim kundërmasa, si përgjigje ndaj ve-

primit të Kosovës. Presim që Qeveria e Kosovës të tërheqë masën e miratuar me çka do ta tejkalojmë kontestin" Ndërkohë, tashmë dy ditë në pikën kufitare Bllacë nuk ka kaluar as një kilogram pemë ose perime drejt Kosovës. Tregtarët alarmojnë se produktet bujqësore prishen nëpër magazina meqë tregtarët kosovarë nuk i blejnë ato. Dogana plotësuese ndaj produkteve bujqësore filloi më 19 korrik. Vitin e kaluar nga Maqedonia në Kosovë janë eksportuar pemë dhe perime në vlerë prej 6 milionë euro, ndërsa vetëm nga fillimi i këtij viti eksporti është mbi 2,5 milionë euro.



NËN KËRCËNIMIN E ARMËS, 31-VJEÇARJA NGA MALLAKASTRA VODHI NJË KARBURANT

Personi që shihni në foton me poshtë është 31 vjeçarja Anna Malaj nga Mallakastër, e cila u ndalua ditën e sotme nga policia pasi në bashkëpunim me E.G, 22 vjeç, nën kërcënimin e armës kanë vjedhur një pikë karburanti.

Të dy këta shtetas Kushërinjë me njeri tjetrin, nën kërcënimin e armës, në datën 02.07.2018, në Levan, kanë vjedhur një pikë karburanti ku kanë marrë shumën prej 30000 lekësh të reja, s hkruna fax web. Gjithashtu të dy këta shtetas nën kërcënimin e armës kanë ten-

tuar të vjedhin dhe dy pika të tjera karburantesh. Në datën 07.07.2018, në Mallakastër, nën kërcënimin e armës kanë tentuar të vjedhin një pikë karburanti por pasi janë ndeshur me punonjësin e karburantit, janë larguar. Si dhe në datën 15.07.2018, në lagjen "1 Maji" Fier, në bashkëpunim, duke kërcënuar me armë gjahu teke, kanë tentuar të vjedhin një tjetër pikë karburanti. Gjithashtu policia ka sekuestruar dhe armën me të cilën autorët nën kërcënimin e saj kryenin vjedhjet.

JA NJOFTIMI I PLOTË I POLICISË

Specialistët e Seksionit për Hetimin e Krimeve kundër pronës dhe pasurisë në Drejtorinë Vendo-

re të Policisë Fier, falë punës operative e hetimore të mirëorganizuar, bënë të mundur zbardhjen e tre ngjarjeve të ndodhura këtë muaj në Qarkun e Fierit ku dy persona nën kërcënimin e armës, gjatë orëve të vona të natës shkonin për të vjedhur pika të ndryshme karburantesh. Gjithashtu u referuan materialet në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier dhe po punohet për kapjen e shtetasit: E.G, 22 vjeç, banues në fshatin Belinë, Patos. Në datën 07.07.2018, në Mallakastër, nën kërcënimin e armës kanë tentuar të vjedhin një pikë karburanti por pasi janë ndeshur me punonjësin e karburantit, janë larguar.

Në datën 15.07.2018, në lagjen "1 Maji" Fier, në bashkëpunim, duke kërcënuar me armë gjahu teke, kanë tentuar të vjedhin një tjetër pikë karburanti. U sekuestruan në cilësinë e provës materiale: Automjeti me të cilën shkonin në vendngjarje, 1 armë gjahu teke dhe 6 fishekë, 1 palë doreza dhe 4 targa mjete të falsifikuara.

Materialet i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier për veprat penale "Vjedhja me armë", e kryer në bashkëpunim e mbetur në tentativë" dhe "Prodhim dhe mbajtja pa leje e armëve dhe municionit luftarak" parashikuar nga Nenet 140, 22, 25, dhe 278 të Kodit Penal. (Syrinet)



Nëna çon djalin në pranga: Më rrihte, e duroja prej turpfit

Një grua nga Cërriku ka rënë pre e dhunës së djalit të saj, duke bërë që të kërkojë ndihmën e policisë.

Emiljano Fejzo, 30 vjeç, banues në lagjen Nr.1 Cërrik u arrestua këtë të diel, pas denoncimit të bërë nga e ëma. Ai akuzohet se në banesën e tij ka ushtruar dhunë fizike dhe psikologjike ndaj nënës së tij, H.Fejzo, 60 vjeçe.

Gruaja ka thënë para uniformave blu se i biri e ka dhunuar edhe herë të tjera, por se ka duruar "prej turpfit" dhe çfarë mund të thoshin njerëzit. Por për shkak se situata u rëndua së tepërmi gjatë së dielës, vendosi që ta denoncojë.

Ndaj 30-vjeçarit materialet iu referuan Prokurorisë së Elbasanit, për veprën penale "Dhuna në familje". (NOA)

Infermieri sulmohet nga pacienti në QKUK

Sindikata e shëndetësisë së QKUK-së, njofton se të dielën në orën 03:05 min në turin e natës, në vendin e punës është sulmuar fizikisht infermieri i klinikës emergjente, Lulzim Thaqi nga, siç thonë ata, pacienti-i sëmurë. Përmes këtij reagimi, ata shprehin indignatën e shqetësimin e tyre.

Reagimi i plotë:

"Ky fenomen shqetësues, dhuna ndaj mjekëve ka pasojat të shumta jo vetëm për mjekët por edhe për vetë të sëmurët, cilësinë e shërbimit, mbrojtjen e shëndetit të popullatës, marrëdhëniet mjek-pacient dhe për mbarë shoqërinë. Vazhdimësia e këtij fenomeni në këto



ritme dëshmon se nevojitet një vlerësim më serioz, dhe një angazhim më i madh. Cilido që ofendon apo godet mjekun—infermie-

rin duhet të jetë i qartë se ka përpara personin që ka shpëtuar dhjetëra jetë njerëzish...

Mantelbardhet te cilët i nën-

shtrohen sjelljeve të dhunshme nga pacientet ose palët e treta gjatë ushtrimit të detyrës duhet mbrojtur në mënyrë imediate, duke hartuar strategji parandaluese të këtij fenomeni të shëmtuar, duke i evidentuar-raportuar rastet e tilla e sigurisht duke i zgjedhur ato! Në situatë e në rrethana të tilla represioni e kërcënime ndaj tij detyrimisht personeli do të fillon të bëjë mjekësi defensiva.. Ndjekja e këtyre akteve të dhunës i takon shtetit, të tilla vepra janë të sanksionuara edhe në Kodin Penal të RKS. Andaj kërkojmë mbrojtjen e mantelbardhëve, rivendosjen e dinjitetit të mjekëve e personelit mjekësorë!"

DETAJET PËR TË RIUN QË HUMBI JETËN NË VELIPOJË Për një javë prisnin dasmë por erdhi morti



Dalin detaje të reja lidhur me 29-vjeçarin Ervid Palaj, i cili humbi jetën këtë të diel në plazhin e Velipojës. Gjithçka ndodhi teksa Palaj, arriti të shpëtojë nga dallgët të fejuarën e tij Lori, e cila ndodhej në rrezik, tramseton NOA. Nga të dhënat paraprake, bazuar edhe në dëshmitë e të pranishmëve, bëhet me dije se i riu humbi jetën në tentativë për të shpëtuar të fejuarën e tij, e cila nuk ka rrezik për jetën. Por pasi ka shpëtuar vajzën e zemrës, Palaj nuk ka

mundur të dalë dot, për shkak edhe të detit me dallgë. Por ndërsa dita e djeshme, duhet të ishte për tu argëtuar dhe çlodhur, ndodhi gjëma. Kjo pasi fundjavën që vjen në familjen Palaj kishte dasmë, por para saj priu erdhi morti. Ervidi do martonte të motrën për pak ditë, por në vend të rrobave të bardha, humbja e të vëllait e veshi të renë me të zeza. Një dhimbje e madhe për familjen Palaj, e cila në vend të ahengut, ia ka lënë vendin kujës dhe vajit.

Vriten pesë anëtarë të një familje pas një konflikti për pronë

Konflikti për pronën ka përfunduar me vrasjen e 5 pjesëtarëve të një familjeje në Turqi. Në konflikt e sipër, autori qëllon për vdekje të atin, të vëllain, kunatën dhe 2 nipat ndërsa më pas e drejtoi pistoletën edhe në kokën e tij. Ngjarja e rëndë ka ndodhur paraditen e së dielës, rreth orës 11:00 në një fshat të distriktit Besni të provincës Adiyaman. Sipas agjencisë së lajmeve "IHA", babai dhe dy djemtë po debatnin për ndarjen e një ngastre toke kur u nxehën gjakrat.

Pas përfshirjes në konflikt edhe të 2 nipave, Salih A. ka nxjerrë pistoletën nga brezi duke qëlluar të atin, vëllain e tij të madh, kunatën dhe 2 nipat. Më pas ai qëllon edhe veten në kokë. Në vendngjarje mbërritën menjëherë ekipet e xhandarmërisë dhe ambulancat, por fatkeqësisht nuk mund të bënin asgjë për të shpëtuar familjarët. I vetmi që u dërgua i plagosur rëndë në spital ishte autori i krimit të rëndë.

(tvklan)



Opinionkrijusit vajorë!

Nga

Adelina MARKU



Nuk është e lehtë të mbash kondicion në të shkruar...! Do thoja - është sfidë kreativiteti, biles është dhe përgjegjësi. Aq më shumë kur krijon opinion për filan ngjarje ose për filan personaliteti mbi të cilën (cilin) të gjithë flasin ndrysh 'ndrysh' e për të cilën (cilin) vrap, japin një cilësim vajor orkestrus - do thoja unë - pra n'sipërfaqe e me huxhum...! Gjërat vështirësohen më shumë kur njeh veten si shkrojtës që në një moshë të njomë fare e kur je rritur bashkë me shtetin e kur gjen veten sot të kesh haruar ngjarje të cilat kanë bërë kthesën e madhe në jetën e shtetit por jo në cilësinë e jetës tëndë...Pse kjo harresë? Ngjarja zen ngjarjen, ajo e djeshit interpretohet ndryshe nesër e ku më pas do viteve dhe e vërteta mer trajta shumë më ndryshe se çka ka qenë realisht. Sidomos kur ajo bëhet pjesë e një maqinerie propaganduese dhe PR! Ja se përse harresa! Pastaj, fenomeni i demberlekut (i të shtypurit) e ka bërë të veten, neve nuk ia kemi për zana arkivimit vigilent të ngjarjeve dhe të vërtetave faktike, prandaj...me kalimin e kohës e me të vërtetën lënë pezull në ajër...interpretimet e bëjnë të vetën! Si do quhej e vërteta e para do viteve sot psh? Përsëri e vërtetë?! Vështirësia vjen atëherë kur pjekuria personale të shndërrohet në ankthuse biles "armike" ndaj qetësisë intelektuale vetanake ngase gjen veten vazhdimisht tuj kriju në një nënqiell ku njerëzit nuk shkruajnë por e bajn thashethemin ushqim ditor, nuk arkivojnë të vërtetën e prandaj ajo bëhet njëkohësisht pjesë narrative e gojës ujçërve me po aq lukuni sa'ç'a bahet pjesë e gojës s' qingjave...Hah' nuk dijs kush o ujç e kush o qingj ma! Ajo çka mbetet sfidë e madhe e për të gjitha dekadat që kanë kaluar, mbetet e vërteta mister. Psh, për mua është ende sfidë e madhe afëra e armëve t'a zamë, ose konflikti i 2001 psh, imputimet politike të asaj kohe, statistikat ekonomike që bienin në kundërshtim me revoltën që u nxit, ndërrimi rrëdhim makiavelist e përcudnues i lidershit, propaganda "luftarake", propaganda parapaqësore, propaganda pas marëveshjes, arsyt, kurdisjet pas 2001..., ardhja në pushtet e të majtëve maqedonas nga e najta priviniencë politike që ish paradoksalisht e pozicionuar ndaj

të drejtave të shqiptarëve para e tani krejt ndrysh pas 2001..., masnej ardhja e të djathtëve tanimë të hijenëzuar në diskursin e tyne kulturocidal ndaj shqiptarëve...ahhhh, sa shumë krrojtje e plagë gjak më shkaktën e vërteta. Ndërsa ne...heshtim, tkurremi në ndërgjegjet tona parainteletuale dhe prodhojmë sipërfaqësi politike! Pa folur për dhimbjet e së vërtetës, nuk ndihem e plotë..., nuk jam tansi, nuk di të baj rrëfimin e plotë...! Masnej e për më keq, e di se do mbetem kështu siç jam, pa tansi!

Dhe kështu kemi ndihmuar sipërfaqësinë kulturore, ekonomike e politike të kulmojë në jetën tonë! Prandaj, shumë nga shkrojtësit (analistët) e kanë më të lehtë qasjen holistike ndaj fenomeneve e ngjarjeve se sa t'bamit me analizën argumentuese, atë që përmban numra, fakte, statistika; psh para do ditësh lexova një shkrim mbi një personalitet politik e për hesapin tim shkrimi qe brokerus - i thomi ne në zhargonin e zhurnalistikës, ngase flitej me simpati për figurën e një lideri politik (në maja qeveritare gati 20 vjet tanimë) në një kohë kur treguesit

ekonomik flasin për uljen ma të madhe të mundshme të zhvillimit ekonomik në vend e kur shifrat e ikjes së të rrinje nga vendi po kapin kulmin e havasë. Thash me vete, çka "mutin" po vjell ky shkrojtës kështu, çka dhe kend po don me bind me erën që pluhuros shkrimi i tij!? Ujqoqengjërit me gjasë...veten!? Konstatimi im është si vijon: nuk është koha për të lartësu personalitetet politike të vendit o miq e mikës! Dëgjo, unë mendoj se ne jetojmë në PANEVOJËN E MADHE për të naltu dikend biles! Rënia drastike intelektuale, regresi ekonomik, zëvendësimi i kultivimit kulturor me rrena imputuese pseudoklerikësh fetarë, papunësia e madhe dhe ikja pakthim e të rinje nga vendi nuk mbulohet dot me shikime arritësh holistike të figurave politike. O asht marre e madhe të harrohet e vërteta, të shkelet vetja! Figurat politike sot - janë goxha në rënie, nuk asht ndoj ngrefje të bësh politikanin sot a, mjafton të ndiqni kurbën e lëvizjeve të karierave të tyne politike dhe kjo do ju shpalos paradoksin vetë! Në hesapin tim shkrojtësi i tekstit kish portretu një rrenë të

Ne...heshtim, tkurremi në ndërgjegjet tona parainteletuale dhe prodhojmë sipërfaqësi politike! ... Ne jetojmë në PANEVOJËN E MADHE për të naltu dikend biles! Rënia drastike intelektuale, regresi ekonomik, zëvendësimi i kultivimit kulturor me rrena imputuese... Ah dhe kjo derexhe hajdash parainteletuale që nuk do arrin t'i sfidojë kurrë autokratët e kohës sonë!!!!



madhe publikut...për më keq edhe vetes! Nuk do përmend emrin e shkrojtësit, as shkrimin, ai do gjen veten lehtazi në shkrimin tim!

Për më shumë, dhemb ajo që është "Al"...burra, jo burra!

Të nderum, koha në të cilën jetojmë, pra koha ku ujku dhe qengji flenë bashkë, pjell analista të këtij lloji, brokerë të tillë që ngrenë pamflete mbi personalitete politike tuj e bo vështrimin mbi ta nga prespektiva e zogut, nga nalt pra. Kjo lloj analize nga naltë, faaap e relativizon kohën e gjatë të sundimit të një konjunkturë politike, e rrafshon dhimbjen dhe mundimin e gjatë, e zhvendos aty për aty manipulimin ndaj votuesit, i fshin si me gomë statistikën, ngjarjet e numrat. Hmmm, cili mbetet tregues për sukses lidërshipi atëherë? Si matet? Pra këta lloj analistësh kohën e gjatë të gjithësundimit absolut e gjithëpërfshijnë shpejt e shpejt në një kolumnë të vetme dhe kjo metodë makiaveliste ndihmon që madje edhe lidërshipi e Enver Hoxhës t'a shndrosh në simpatik a. Keni dëgju psh për konstatimin se po mos ish Enver Hoxha ne shqiptarët do kishim mbetur analfabet? Oh sigurisht qe e keni dëgjuar

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Rattkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goca Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovassja lok.14 - përdhësë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypit dhe distribuimi: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e hënë 23 korrik | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006

Drejtor: Lirim DULLLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA

E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribuim: Afrim DULLLOVI - Tel: 071 372 221

Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

konstatimin banal a, e prandaj pak nga ne janë lodhur të argumentojnë të kundërtën! Vërtetë analfabetë nuk kish në peridhëun e komunizmit në Shqipëri, por asnjoni nuk bën vrap të thotë se kish diktaturë të hekurt ore, kish shfarrosje intelektualësh e mendimtarësh si askund në botë, kishte analfabetizëm por njëkohësisht depersonalizëm, gjenocid intelektual, kish hipnozë politike por dhe kameleonizëm paroksik politik nga vetë Enveri—(...në mujshta me u shpreh në këtë formë!). Atëherë, kush o' bre ai/ajo hajvan/e që rrumbullakon suksesin tuj u vëmndesu në arritje simbiloke?! Ose, keni dëgju për konstatimin se shqiptarëve ju duhet bre një dorë e hekurt si e Enver Hoxhës se s'boheshin njerëz ata kurrë. Por asnjoni nuk ka bërë analizën e portretimit se çfarë Shqiptari do bënte liria nga ai/ajo e çfarë boni diktatura nga ai/ajo! Z

Të nderum/e, zhdukja e analfabetizmit përgjatë 50 vjeçarit të diktaturës së Enver Hoxhës është njësoj sikur sot të bësh me ekzaltim lavdërimin e punësimit të shqiptarëve në administratën shtetërore. Shkurt, shqip! Mendoje saças, boje analizën dhe e ke të lehtë të konstatosh se masovizmi kronik i një politike të vetme populiste nëtëvërtetë e dëmton mendimin kritik dhe e kërcënon individualizmin si spikamë shoqërore prandaj dhe kujdes lexues I/e nderum/e, sepse kur jepen kësi konstatimesh ekzaltuese e parainteletuale, pohuesit vajorë janë nga më të ndryshmit e fatqësishit nga më të numërtit. E ti lexues, mbetesh I vetëm për të konstatu me veten se gjendja jote ekonomike vazhdon të jetë më e rrëndë se sa që ishte dje e se, sa vjen e më shumë ke fillu të relativizosh përkatësinë kulturore dhe fuqinë që të jep ajo!

Asht koha të bajm analizën ndryshe o miq e mikeshë që shkruani (që shkruajmë)! Të heqim në mënyrën më agresive biles nevojën patologjike (polltrone) për me lartësu personalitete politike e liderësh për së gjalli, sepse në këtë mënyrë ma së shumti i dëmtojmë ata—personalitetet politike pra, i rrejme me shijet tona polltrone ndaj liderit të tyre, ndërsa për veten - vetëm vërtetojmë se sa bythëlëpirës qenkemi e çfarë tansi parazitësh pasqyrokem! Asgjë më shumë. Me automatizëm zhvendose krijimin intelektual tuj i bo pyetjen bazike vetes: çka ke bo vete për me ndërri cilësinë e jetës që po t'a ndërton ai që ti e ke lartësu me polltronizëm e bythëlëpimje? Kur kjo pyetje do mer përgjigjet tua, ama të sinqerta...tek atëherë do shohësh se çfarë intelektual KOT ke qene një jetë të tanë...! Prandaj...ah dhe kjo derexhe hajdash parainteletuale që nuk do arrin t'i sfidojë kurrë autokratët e kohës sonë!!!!

Jeta sekrete e Obamave në Uashington

Asnjë president modern nuk ka qëndruar në kryeqytetin e SHBA pas largimit nga posti. I fundit ishte Woodrow Wilson më 1921. Kështu që ideja e Obamave tërheqës e energjikë-dy nga njerëzit më të famshëm në botë-që jetojnë në kryeqytet ishte gjë e madhe. Shpresat ishin të mëdha.

Uashingtonasit e vjetër shpresonin që ata do të bëheshin ambasadorë jozyrtarë për kryeqytetin e vendit, duke e përfqafuar qytetin e tyre të adoptuar. Por përkundrazi, ata përfqafuan jetën e re si qytetarë privatë, me theksin te 'privatë'.


Në 18 muajt e fundit-përveç disa shfaqjeve publike të përgatitura me kujdes-ata janë parë rrallë në qytet. Iu pëlqen ende të shkojnë në restorante dhe të ndjekin ekspozitën apo teatrin e radhës. Por jashtë një rrethi të miqsh të ngushtë, ata fluturojnë së tepërmi poshtë radarit.

'Mendoj se Obamave ndoshta iu pëlqen që njerëzit në Uashington i lënë ta jetojnë jetën si qytetarë privatë dhe vazhdojnë të jenë pjesë e këtij komuniteti', thotë Stephanie Cutter, e cila ka shërbyer në Shtëpinë e Bardhë në kohën e Obamës. Ata kanë krijuar një flluskë mbrojtëse që iu lejon fleksibilitet maksimal dhe ekspozim publik minimal. Flluska është reale: Rruga para shtëpisë së tyre është e bllokuar nga një makinë policie, me oficerë në shërbim 24 orë, një shërbim sigurie standard për çdo ish-president.

Vizitorët në zonë duhet të komunikojnë më parë me policinë para se të shkojnë në ndonjë nga shtëpitë. Jo se ndokush do të ndeshë me Obamat: ata rrallë shëtisin qenin para shtëpisë dhe hyjnë e dalin nga një hyrje e sigurt anësore e shtëpisë. Por flluska është edhe figurative: Banorët aty pranë nuk flasin për fqinjët e tyre të nderuar. Obamat, thonë ata, janë të qetë, nuk tërheqin vëmendje dhe e ruajnë privatesinë.

Përmes zëdhënësës, Obamat refuzuan të komentonin për këtë artikull. Dhe askush nga rrethi i brendshëm i tyre nuk do të fliste për jetën e tyre post-presidenciale në Uashington.

Ndaj, harroje Uashington! Obamat mund të kenë një shtëpi në kryeqytetin amerikan, por nuk do të jenë kurrë realisht Uashingtonas. Shumica e njerëzve mendonin se Obamat do të ktheheshin në Chicago, ku ende kanë shtëpinë e tyre në Hyde Park. Por 8 muajt para largimit nga Shtëpia e Bardhë, presidenti tha se do të qëndronin në Uashington deri sa vajza e vogël, Sasha, të mbaronte shkollën, në Sidwell Friends, në qershor 2019.



Kur Barack dhe Michelle Obama njoftuan se do të vazhdonin të qëndronin në Uashington pas tetë vjetëve në Shtëpinë e Bardhë, pati mermërima pa fund. Lëvizja tradicionale për jetën post-presidenciale është kthimi në shtëpi: një kthim në rrënjë, një bibliotekë presidenciale dhe dekorim për merita të shquara

Blerja e shtëpisë për 8.1 milionë dollarë pranverën e kaluar lë të kuptosh se ndoshta mund të qëndrojnë edhe pas mbarimit të kolegjit nga Sasha. Michelle në programin e Ellen DeGeneres se familja ishte mësuar tashmë me shtëpinë e re. Barack, shpjegoi ajo, përdor dhomën më të vogël si zyrë, Sasha ka një suitë dydhomëshe, sepse është femija i vetëm në shtëpi, ndërsa Malia-e cila nisi studimet në Harvard vjeshtën e kaluar pas një viti pushim-'ka një dhomë diku në papafingo'.

Ish-presidenti ka një zyrë në West End, ku shkruan kujtimet dhe pret miqë. Luan shumë golf. Obama hyri në Columbia Country Club dhe Robert Trent Jones Golf Club por luan në të gjitha fushat e golfit në qytet.

Michelle frekuenton rregullisht palestrën Solidcore, e cila nuk flet për klientët e saj. Dhe sigurisht që frekuentojnë restorantet, një zakon që e kanë ruajtur që nga vitet e Shtëpisë së Bardhë. Vitin e kaluar kanë ngrënë te Dabney, Rasika, Del Mar, Maydan e Fiola Mare, për të përmendur disa emra, gjithmonë në ambiente private. Megjithatë, privatesia vështirë se ruhet kur bëhet fjalë për shfaqje të Obamave në restorante. Dikush postoi në

Twitter një foto të çiftit në Tail Up Goat; një tjetër klient i emocionuar postoi një video të ish-presidentit në Nobu.

Në mars, pronarja e Hank's Oyster Bar, Jamie Leeds, twittoi takimin e saj me Obamën, duke pranuar se ishte mahnitur. Sigurisht që ata nuk mund të shkojnë direkt e në restorant. Skuadra e sigurisë shkoi në dy ditë më herët dhe siguroi vendin për ditën e rezervimit. Obamat, Valerie Jarrett dhe miq të tjerë u ulën në një tryezë në qoshe, agjentët e sigurimit në tryezën pranë. Klientët bënë foto nga larg, por nuk u afruan; dikush qerasi me një raund pijesh. Në dalje, pati shtrëngime duarsh. 'Mund ta ndieje energjinë në lokal', tha Sabrina Zahid, drejtore marketingu e restorantit. 'Mund ta thuash që ishte natë speciale'.

Pavarësisht gjithë kësaj, pse duket sikur ata nuk janë vërtet aty?

Nga pikëpamja politike, mbajtja e një profili të ulët është traditë e hershme: Konsiderohet jo-etike që një president të errësojë apo kritikojë pasardhësin, diçka që është më e mundshme të ngjasë kur jetojnë në të njëjtin qytet. Por edhe për shkak se ata udhëtojnë shpesh për promovimin e platformave të preferuara: liderhipin e rinisë, kujdesin shëndetësor, të drejtat e grave dhe mirëqenien. Këtë javë, Barack është në Afrikën e Jugut për përkujtimin e ditëlindjes së Mandelës; Michelle është në Paris për koncertin e Beyoncé dhe Jay-Z. Disa nga udhëtimet përfshijnë fjalime me pagesë, 'veza e artë' moderne për çdo ish-president e 'first lady'. Kuotat që paguhen janë sekrete, por sipas shumë shkrimeve në media Obamat paguhen goxha

mirë. Ai merr mesatarisht 400 mijë dollarë për fjalim, ajo rreth 200 mijë. Zëdhënësi i tij shpjegoi vitin e kaluar se fjalimet i lejojnë çiftit të dhurojë për programet e preferuara sociale. Bëjnë edhe udhëtime ekzotike duke e shijuar jetën: surfing në Karaibe me miliarderin anglez Richard Branson (ia kthyen nderin duke e ftuar për një pije në shtëpinë e tyre në Uashington), një udhëtim luksoz në Toscana dhe pushime vitin e kaluar në Polinezinë Franceze në jahtin 590 milionë dollarë të David Geffen, bashkë me Oprah Winfrey, Tom Hanks e Bruce Springsteen.

'Çfarë ndodh në varkë mbetet në varkë, iu tha Oprah, reporterëve. Ka edhe një faktor tjetër, një aspekt më i heshtur e më i komplikuar i jetës së tyre në Uashington: Shumica e miqve të ngushtë janë afro-amerikanë. Ata enden në një rreth ekskluziv elitare që argëtohet privatisht dhe nuk poston në Twitter, Instagram e nuk jep detaje nga jeta e vet, aq më pak e Obamave. 'Uashingtoni i zi nuk vëzhgohet nga Uashingtoni i bardhë, thotë një mik që nuk është i autorizuar të flasë për Obamat, por shoqërohet me ta.

'Ata janë ende çifti i parë i botës. Por nocioni që ata nuk janë këtu është diçka me të cilët të zinj të qeshin'. Këtu rrotull janë, por thjesht janë të mbrojtur, shpjegon. 'Uashingtoni ku lëvizin ata është i përshtatshëm për moshën e tyre. Njerëzit në të 50-at e të 60-at e tyre nuk nxjerrin telefonat e të postojnë për çdo gjë. Kështu që po, Obamat janë me bazë në Uashington-për momentin. Thjesht mos i mbani shumë shpresat që ata vërtet jetojnë aty.

(Marrë nga Uashington Post)

FESTIVALI "VERA E OHRIT"

PARAQITJE DINJITOZE E TEATRIT SHQIPTAR NGA SHKUPI

Skena në qendrën "Grigor Përliçev" në kuadër të Festivalit "Vera e Ohrit" të dielën ishte e rezervuar për shfaqjen "Vdekja e Dantonit" nga regjisori boshnjak Dino Mustafiq, në interpretim të Teatrit shqiptar nga Shkupi.

Dramën "Vdekja e Dantonit" autori Georg Bihner e shkroi në vitin 1937 në periudhën e artë të romantizmit gjerman në moshë jo të plotë 22-vjeçare, vetëm dy vite para se të ndërronte jetë nga tifoja. Pavarësisht ideve revolucionare, autori në këtë dramë tregon edhe dyshim për mënyrën e zbatimit të ndryshimeve revolucionare, duke e parashtruar pyetjen: kur ndalon revolucioni? Mu për atë shkak ngjarja në dramë fokusohet në periudhën

e sundimit dhe përçarjes së vetë revolucionarëve.

Sipas dramaturges së shfaqjes, Zjeljka Udoviçiq – Pleshtina, thelbi i ngjarjes shtrihet në konfliktin mes Dantonit dhe Robespjerit, përkatësisht mes dy botëkuptimeve të ndryshme për atë se çfarë do tëp duhej të ishte shteti pas revolucionit të kryer. Danton mu nga fillimi është shfaqur si person dekadent, i prirë drejt hedonizmit, por qëndriem tija politike janë liberale dhe tolerante. Robespjer, ndërkaq, betohet në virtytin, për vete pohon se ka vetëdije të pastër, por i vret të gjithë të cilët mendojnë ndryshe sepse, virtyti duhet të sundojë me ndihmën e terrorit.

Për shkak të shfrytëzimit të materialit

të apsur dokumentar dhe montazhit të citateve dhe burimeve historike "Vdekja e Dantonit" në kombinim me interpretimin autorial të temës, në kohën kur është shkruar ka shkaktuar shumë kundërthënie dhe e ka pritur paraashfaqjen mbi 60 vite. Sot, kjo vepër konsiderohet si lajmëtare e të ashtuquajturit teatër dokumentar.

Regjisori Mustafiq ka bërë regjinë e mbi 80 shfaqjeve të shkrimtarëve klasikë dhe bashkëkohorë. Ka xhiruar disa filma dokumentarë me të cilët ka marrë pjesë në festivale të shquara për film dokumentar në Montreal, Amsterdam, Stamboll etj.

Për shfaqjen është angazhuar ekip i shumtë me mbi 20 aktorë të Teatrit shqiptar të Shkupit

Vanessa Redgrave shpërblehet me "Hyjneshën e artë"

Ishte prezente në ceremoninë e hapjes së edicionit të parë të PriFest në vitin 2009, ndërsa tash u rikthye pas 10 viteve për ta parë nga afër progresin e këtij festivali.

Bëhet fjalë për aktoren britanike, fituese të çmimit Oscar Vanessa Redgrave, e cila është edhe Presidente Bordit të Nderit të PriFest-it.

Në kategorinë "Projeksion Special", aktorja Redgrave solli filmin e saj të parë të punuar si regjisore, filmin "Sea Sorrow", që vitin e kaluar kishte premierën botërore në Cannes. Filmi është shumë personal e dinamik që trajton temën e krizës globale të refugjatëve.

Në një konferencë pas shfaqjes së filmit, aktorja tha se ndihet mirënjohëse dhe shumë e kënaqur.

Redgrave: Jam e lumtur që u ktheva sërish në Kosovë

"Pse jam mirënjohëse është për shkak se jam ftuar përsëri në këtë vend që kisha ardhur shumë kohë më parë, gjatë okupimit dhe kam takuar përsëri miqtë e mi të dashur që kanë vërtetë respektin dhe dashurinë time", tha ajo.

Aktorja tregoi se i admiron miqtë e saj të festivalit për shkak të vullnetit që po e tregojnë për ta zhvilluar festivalin, përkundër përkrahjes minimale nga institucionet shtetërore, transmeton gazetaobserver.

Ndërsa për aktorët kosovarë dhe ata të rijtë në gjithë botën, Redgrave tha se privatizimi po i dëmton ata dhe arsimin në përgjithësi.

Redgrave: Jam duke punuar një film për Kosovën

"Filmi përqendrohet më shumë në ligjin ndërkombëtar për të drejtat e njeriut, të cilit duhet t'i binden të gjitha qeveritë, nuk mund ta thyejnë këtë ligj. Ekzistojnë Konventa, Konventa Evropiane për Mbrojtjen e Refugjatëve. Ekziston Konventa e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e Refugjatëve, ekziston Konventa e vitit 1989 për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve dhe kjo pak a shumë rrjedh gjatë filmit".

Në shenjë respekti dhe vlerësimi për gjithë përkrahjen e saj ndër vite për komunitetin artistik në Kosovë dhe festivalin, PriFest-i do ta shpërblejë aktoren me çmimin "Hyjneshë e Artë".

"Korça Short Film Fest", triumfon Ylljet Aliçka me "Lule plastike"

Festivali Ndërkombëtar i Filmit të shkurtër "Korça Short Film Fest" në Korçë përfundoi. Rreth 40 filma të ndarë në disa kategori, si dokumentar, fiction, të animuar u prezantuan në ditët që lamë pas në Teatrin "Andon Zako Çajupi" dhe në Pazarin e Vjetër në Korçë, njofton ATSH. Juria ndërkombëtare e festivalit e përbërë nga, Toma Waszarow, regjisor, producent nga Bullgaria, Tudor Vintilou, drejtor fotografie, fotograf nga Rumania dhe Anna Oreshkova, asistente regjisore pranë kompanive filmike amerikane "Nu image" dhe "Ufo" vlerësuan me çmime filmat si më poshtë:

1. Filmi më i mirë i shkurtër për studentët u përzgjedh "Besimi" nga Tatiana Fedorvskaya, Rusi.

2. Filmi më i mirë i shkurtër shqiptar u përzgjedh "Lule plastike" nga Ylljet Aliçka, (Kinostudio Dardan, Shqipëri).

3. Filmi më i mirë i shkurtër fiction "Si një fëmijë i mirë" nga Arian Shkirdaftari, Iran.

4. Filmi më i mirë i shkurtër dokumentar, "Përpara nga Justin Stoneham, Zvicër.

5. Filmi më i mirë i animuar për "Laymun" nga C.Prowse, H.Quin, Mbretëria e Bashkuar.

Subjekti i filmit të shkurtër shqiptar fitues, "Lulet Plastike", me skenar edhe regji nga Ylljet Aliçka ka në qendër ndjenjën e vetmisë të një



çifti të moshuar nga fshati, të cilët vijnë në Tiranë me entuziazëm në një dasëm.

Por kënaqësia e madhe kthehet në vetmi, një ftohtësi nga i gjithë komuniteti qytetar. Krahas kësaj ndjesie vetmie fillon dhe rizbulimi i njëri-tjetrit. Në film luajnë aktorët Robert Ndrenika, Zana Prifti, Gent Hazizi dhe Elia Zaharia.

Juria shpërndau dhe katër çmime speciale si më poshtë: "Njerëz tokësorë" nga Adam Freund Hungari, "Asnjë" nga ElhamTogroji Iran, "Fitorja e bamirësisë" nga Albert Meisl Austri, "Lavanderi publike" dhe Christina Zachariades Portugali.

Të gjithë filmat shqiptarë dhe shqipfolës garuan në garën kombëtare, sipas kategorive të filmave dhe fushave të studimeve, si: filmi artistik më i mirë; filmi dokumentar më i mirë; filmi më i mirë i animuar; regjia më e mirë dhe skenari më i mirë.



Dua Lipa mahnit publikun në Paris

Këngëtarja aq e talentuar dhe bukuroshe, Dua Lipa së fundmi ka performuar në Paris, në festivalin "Lollapalooza" që mbahet çdo vit.

Ajo ka ndarë disa fotografi në rrjetet sociale ku duket e mrekullueshme.


Edhe publiku duket i elektrizuar prej saj.

Lollapalooza mbledh artistët më eminent në botë të zhanreve të ndryshme, transmeton Koha.net.

Përveç Dua Lipës në këtë festival performuan edhe artistët si: Gorillaz, French Montana, Travis Scott, Rag'n'Bone Man, Bastille etj.

NË KUJTIM TË POETIT PODRIMJA

Në shenjë kujtimi e respekti Gjakova e ka një shesh me emrin e poetit tonë të njohur, Ali Podrimja dhe brenda këtij sheshi ka edhe një bust të poetit. Me një organizim letrar-muzikor, Komuna e Gjakovës pati bërë përrurimi i sheshit "Ali Podrimja" dhe zbulimin e bustit të poetit në dyvjetorin e vdekjes (22 korrik 2014)



Argjenda Selmani
Këtë korrik janë mbushur gjashtë vjet që kur afër një lumi të vogël, katër kilometra nga qyteti i Francës, Lodeve, ishte gjetur trupi i pajetë i poetit Ali Podrimja. Lajmi erdhi tri ditë pasi ai kishte ndërprerë çdo kontakt me familjen në Kosovë dhe me organizatorët e festivalit të poezisë "Vox de la Mediteran" ("Zërat e Mesdheut") ku po merrte pjesë poeti atë verë, shkruan gazeta "Zëri".
Vdekja e tij bëri jehonë të madhe në mediat vendore e ndërkombëtare pasi bazuar në veprat e tij, u cilësua madje si vdekje e dashur dhe e kërkuar e një poeti të madh. Podrimja vdiq më 22 korrik të vitit 2012 kurse u lind në vitin 1942 në Gjakovë në kohë lufte e rrethanash aspak të volitshme dhe pati një fëmijëri mjaft të vështirë.

Shkollën fillore dhe gjimnazin i kreu në vendlindje, ndërsa Fakultetin Filozofik, Gjuhë dhe Letërsi Shqipe, në Universitetin e Prishtinës.
Në vitin 1966 zë punë në gazetën e përditshme "Rilindja", në rubrikën e kulturës. Më 1976 kalon në edicionin e botimeve "Rilindja", ku udhëheq bibliotekat: Poezia shqipe, letërsia botërore dhe letërsinë e ish-bashkësisë jugosllave. Podrimja njihet për përmbledhjet e tij poetike nisur nga "Shamijet e përshëndetjeve" (1963), "Dhimbë e bukur" (1967), "Sampo" (1969), "Torzo" (1971), "Lum, lumi" (1982), "Zari", etj.
Botën e vet poetike poeti e artikulon përmes një sistemi figurativ të konsoliduar (veçanërisht me simbolin dhe metaforën) dhe me një shkallë mjaft të lartë ndjeshmërie. Poezia e tij është epitomë

e hermetizmit ku metaforat përbëhen nga disa nivele dhe nën-nivele kuptimore. Manifestimi i kësaj forme poetike u bë i domosdoshëm për poetin, sepse i shërbeu si mburojë kundër sulmeve ndaj ish-pushtetit serb në Kosovë. Pas pavarësisë së Kosovës, poezia e tij rifitoi lirizmin dhe ndjenjën poetike, por pa mundur të dalë krejtësisht nga stili i ngjeshur tradicional shqiptar.
Në shenjë kujtimi e respekti Gjakova e ka një shesh me emrin e poetit tonë të njohur, Ali Podrimja dhe brenda këtij sheshi ka edhe një bust të poetit. Me një organizim letrar-muzikor, Komuna e Gjakovës pati bërë përrurimi i sheshit "Ali Podrimja" dhe zbulimin e bustit të poetit në dyvjetorin e vdekjes (22 korrik 2014). Para adhuruesve të fjalës së shkruar

dhe qytetarëve tjerë, Mimoza Kusari-Lila, aso kohe kryetare e Komunës së Gjakovës, me plot emocion ka shprehur ndjenjat për poetin gjakovar Ali Podrimja, i cili u bë i njohur në tërë rruzullin e krijimtarisë letrare-poetike.
Në anën tjetër verën e vitit të kaluar në Gjakovë u hap edhe një park kulturor që mban emrin e poetit Podrimja. Ky park u funksionalizua me iniciativën e një grupi të rinjve, të cilët kanë konsideruar se mungojnë organizimet konstante në kulturë. Pas një fushate 45-ditore online, për mbledhjen e fondeve për aktivizimin në funksion të kulturës të këtij parku, ata ja arritën qëllimin. Ky projekt është joprofitabil dhe ka si qëllim organizimin e kinemasë së hapur dhe aktiviteteve tjera kulturo-artistike si teatri, muzika

dhe pikturimi në lokacionin e sheshit "Ali Podrimja", prapa Shkollës së Muzikës në Gjakovë.
Ednor Hoti (bashkëkrijues i Sektorit 3, OJQ rinore për kulturë), pati treguar për gazetën "Zëri" se përmes kësaj kampanje ata arritën të mbledhin 11.020 euro nga rreth 80 kontribuues të ndryshëm, kurse pos kësaj aplikuan dhe fituan fonde edhe nga MKRS, GIZ-i gjerman dhe Ambasada Amerikane, nëpërmes KUSA-s.
Kësisoj aty tashmë organizohen aktivitete disa herë në javë ku përfshihen shfaqje filmash, mbledhje muzikore, lexime letrare e diskutime të shumta. Zakonisht hyrja në aktivitetet e këtij parku kushton 1 euro dhe organizatorët të gjitha të hyrat financiare i dërgojnë tek shoqata për fëmijët me down syndrome.

NIS RESTAURIMI I SHTËPISË-MUZE TË VËLLEZËRVE FRASHËRI



Shtëpia muze e vëllezërve Frashëri, monument kulture i kategorisë I, e ndodhur në hyrje të fshatit me të njëjtin emër në qytetin e Përmetit, tashmë i është nënshtruar procesit të restaurimit.
Në këtë shtëpi muze kanë shkruar për të parë nga afër fillimin e këtij kantieri restaurimi specialistët përkatës ku kanë

takuar dhe Marjanën, një banore e cila që prej 25 vitesh kujdeset për këtë shtëpi plot dashuri, transmeton ATSH.
Për restaurimin "Shtëpia e Vëllezërve Frashëri", janë parashikuar ndërhyrje në restaurimin e çatisë, dyerve dhe dritareve në përgjithësi, eliminimin e çarjeve në fasadë, restaurimin e dyshe-

meve dhe riparime në suvatime. Gjithashtu do të bëhet sistemimi i terrenit përreth.
Kjo shtëpi muze është ndërtuar në vitin 1974 mbi rrënojat e banesës së vjetër të shkatërruar. Ajo u rikonceptua si një përmbledhje e historikut të zonës, e veprimtarisë së tre rilindasve dhe është pjesë e rëndësishme e tra-

shëgimisë kombëtare.
Me ringritjen e saj është bërë përpjekje për ruajtjen e origjinalitetit të volumit fillestar, duke shuar elemente të reja si, ndërkate e tavane druri dhe oxhakët nëpër dhoma.
Disa nga dhomat e kësaj shtëpie-muze pasqyrojnë mënyrën e jetesës së kohës, duke ekspozuar


orendi të vjetra të mbledhura edhe nga banorë të zonës.
Interesi për këtë banesë duket se është jo i pakët, për vetë rëndësinë dhe historinë që ajo ka. Shtëpia-muze përmban në fondin e saj libra e dorëshkrime të vëllezërve Frashëri, ku mund të veçojmë disa botime origjinale të Sami Frashërit.

Kush ishte Guillaume Apollinaire?

Guillaume Apollinaire (Gijom Apoliner) u lind me 26 gusht 1880 ne Rome. Fëmijërinë dhe rininë e parë i kalon në Itali. Me 1886 familja vendoset në jug të Francës, ku ai shkollohet ndërsa me 1899 shpërngulet ne Paris. Këtu ai mrekullohet nga bibliotekat e pasura e njekohesisht nis te shkruaje. Me 1909 Apolineri boton librin e pare, Magjistari i kalbet, rrefim ne proze i frymezuar nga legjendat mesjetare frenge. Në këtë periudhë talenti i tij shperthen dhe botimet ndjekin njeri tjetrin, per te kulmuar me vellimin poetik Alkoole dhe ate kritik – Piktoret kubiste, meditime estetike. Me shpërthimin e luftes se pare boterore ai angazhohet ne artileri, por plaga që merr ne kokë ne mars 1916 e detyron ta lërë frontin e të kthehet në Paris. Në fund te atij viti ai boton vellimin me novela Vrasja e poetit, kurse me 1917 dramen Gjinjte e Tiresias, qe mbahet si vepra inaguruese e surrelizmit. Me 1918 del nga shtypi vëllimi poetik Kaligrama, qe shquhet per format e reja dhe teknikat novatore, te cilat adaptohen masivisht nga brezi i poeteve moderne mes dy luftërave boterore. Ate vit, ne maj Apolineri martohet, por semundja e gripit spanjoll nuk i la kohe ta gezoje lumturine e re: vdiq me 9 nëntor 1918.

Apollinaire njihet edhe si mik i Faik Konicës, me të cilin pati letërkëmbim, kurse vëmendjen e tij e kishin tërhequr temat shqiptare. Ai kishte mbajtur shënime, dhe në një rast kishte shkruar: "Kruja, kryeqyteti i lashtë i Skënderbeut, themel i një Europe të re. Çështja shqiptare u duket diplomatëve që rregullojnë fatet e botës, tepër e vogël në krahasim me çështjet tepër të mëdha që i detyrohen vëmendjes së Gjithësisë së tronditur. Diplomatat e mëdhenj ndoshta gabohen. Ndoshta, krejt të habitur, do venë një ditë në Janinë a Krujë, kryeqyteti i lashtë i Skënderbeut, të vendosin, me dorë të pasigurt themelet e një Evrope të re."

GUILLAUME APOLLINAIRE



Ura Mirabo

Poshtë urës Mirabo lumi Senë shkon
pse m'u kujtua vallë
dashuria jonë
pas hidhërimit gaz kishim gjithmonë
Le të bjerë nata ora të kumbojë
ditët seç po ikin, unë këtu qëndroj
Kapur dorë për dore le të rrimë përballë
ndërsa poshtë
urës së krahëve tanë
e lodhur vështrimesh, vala para çan
Le të bjerë nata ora të kumbojë
ditët seç po ikin, unë këtu qëndroj
Ikën dashuria si ky ujë që rrjedh
ikën dashuria si kjo jetë e qetë
dhe si shpresa që është kaq e sertë
Le të bjerë nata ora të kumbojë
ditët seç po ikin, unë këtu qëndroj
Tretën ditët, edhe javët tretën
as kohë e kaluar
as dashuritë s'kthehen
poshtë urës Mirabo shkon lumi i Senës
Le të bjerë nata ora të kumbojë
ditët seç po ikin, unë këtu qëndroj.

POEME PER LU...

E vogla, e ëmbla ime Lu, të dua,
Ylli im i shtrenjtë e dritherues, të dua,
Trup delikat e tepër elastik, të dua,
Seks që shtrengohet si thyeres arrash të dua,
Gjoks i majtë i rrallë e provokues, të dua,
Gjoks i djathtë i butë si trendafil, të dua,
Thithkat e tyre ngjyre shampanjë, të dua,
Kërthizë si henë e ngrenë, të dua,
Ije të bardha me drite mermeri, të dua,
Kofshë si kolona tempujsh antike, të dua,
Seks i erret si pylli në dimer, të dua,
Qafëz me kurbat e një mjelme, të dua,
Veshë të brishtë si bizhu meksikane, të dua,
Flokë të ngopur në gjak dashurie, të dua,
Shpinë harmonike me kurbe për mua, të dua
Gojë e embël e plot nektar, të dua,
Shikim i zjarrtë, plot dritë si yll, të dua,
Duar që ngjallin veç adhurim, të dua,
Hundë e vockel, e imtë, aristokrate, të dua,
Hap i hedhur plot nur si në valle, të dua,
O, Lu-ja ime e vockel, të dua, të dua, të dua !...
Shqipëroi : Simbad Detari

FOTOGRAFIA

Më josh buzëqeshja jote
Ashtu si do të mund të më tërhiqte një lule
Fotografi ti je kërpuhda brune
E pyllit
Bukuria e saj
Bardhësitë janë
Një qartësi hëne
Në një kopsht paqësor
Plot ujëra të vrullshëm, dhe kopshtarë
diabolikë
Fotografi ti je aroma
e afshit
Bukuria e saj
Dhe ka tek ti
Fotografi
Tone indiferente
Aty dëgjohet
Një melopë
Fotografi ti je hija
E diellit
Gjithë bukuria e tij.

NISJA

Dhe fytyrat e tyre ishin të zbehta
Të thyera dënesat e tyre.
Si dëborë me petale të pastra
Ose si duart e tua mbi puthjet e mia
Binin gjethet e vjeshtës.

STARTI

Ishte aq e bukur
Sa s'do guxoje ta dashuroje
I doja gratë e tmerrshme në lagjet e mëdha
Ku lindte çdo ditë ndonjë qenie e re
Hekuri ishte gjaku i tyre flaka truri
E doja e doja popullin e zot të makinave
Luksi dhe bukuria janë vetëm shkuma e saj
Ajo grua ishte kaq e bukur
Sa më frikësonte
Përktheu: Faslli Haliti

Cemal Şakar vjen me libër të ri me tregime



“Kopshtet e portokajve” është libri i dhjetë me tregime i autorit Cemal Şakar.

Në këtë libër janë 18 tregime të cilat gjithmonë kanë kujdes

ndaj tënjerëzishmes dhe vërtetësisë, lënë hapësirë për zërat e vërtetë,

fytyrat, jetët, dhimbjet dhe shpresat njerëzore, duke i pasuruar

këto e mundësitë e formave dhe elaborimeve, përpiqet që pa asnjë ndërprerje të lexuesi të arrijë projeksioni i parafytyruar në imagjinatën e autorit.



Kafka në breg, Haruki Murakami

Kafka Tamura, një i ri pesëmbëdhjetëvjeçar, largohet nga shtëpia me dëshirën edhe t'i shmanget profecisë edipiane të të atit, edhe të kërkojë motrën dhe nënën e tij të humbur prej kohësh.

Ndërsa Kafka largohet, po njësoj ndodh edhe me Nakatan, një djalosh i ri leshko, jeta e të cilit është trazuar nga një vrasje e tmerrshme dhe që pas një incidenti gjatë Luftës së Dytë Botërore ka fituar aftësinë të komunikojë me macet.

Ajo çfarë ndodh pas kësaj është një lloj odiseje e dyfishtë e tyre, jo të lidhura drejtpërdrejt, por me shtigje që krijojnë lidhje mes tyre. Murakami dëshiron të mje-

gullojë kufijtë mes reales dhe surreales, me çudira marramendëse, por edhe me një rrëfim prekës mbi dashurinë, vetminë dhe miqësinë.

Me raste autori shkon shpesh në rrëfime metafizike, si e folur dygjuhëshe, ngjarje që ndodhin jashtë kohe, duke e çuar fundin aty ku vetë Murakami përpiqet vërtet t'u japë kuptim gjërave. Kështu lexuesi detyrohet të shkojë, sikurse karakteret e këtij libri, atje ku i shpie autori, pavarësisht në e pranojnë apo e kuptojnë atë.


John Updike: "Një roman që vërtet nuk të lëshon dhe që njëmend ka një ngulmim marramendës metafizik."



Tregime të zgjedhura

Përmbledhja me tregime të zgjedhura nga autorë të shquar, si: Alice Munro, Margaret Atwood, Joyce Carol Oates dhe Hart Wegner, synon të sjellë në vëmendjen e lexuesit një letërsi cilësore. Një ndër elementet më të rëndësishme që i bashkon këta autorë në një vepër të vetme, është fakti që të gjitha historitë mund të konsiderohen si "fëmijë të Çehovit". Detajet për çdo personazh janë ndërtuar me po aq kujdes sa edhe ngjarjet që i rrethojnë ata, e megjithatë, përtej një realizmi të tillë, gjithkush mund të rrokë kuptimin e vërtetë të jetës. Jeta e njerëzve të zakonshëm është pasuruar me imazhe dhe simbolika të jashtëzakonshme.

- "Ketzali mahnitës", "Beti" – Margaret Atwood, Fituese e çmimeve "Arthur C. Clarke" dhe "Princi i Asturias" për letërsi
- "Në zonën e akullit", "Ku je... Ku ke qenë" – Joyce Carol Oates, Kandidate për çmimin "Nobel"
- "Përballë liqenit", "Burrnisha shqiptare" – Alice Munro, Nobeliste
- "Një vdekje në qytezën e qetë", "Përkrenarja e florinjte" – Hart Wegner Fitues i çmimit "Pushcart"



"E fshehta e shëronjësës", Sabine Ebert

Lëreni Saksoninë e shek. XII t'ju marrë me vete...

Zotërimi i aftësive të rralla, mund të jetë fat... ose disfatë... Në rastin e shëronjësës së re, Martës, e cila mund të shërojë edhe me një prekje të dorës dhe është e aftë të parashikojë ngjarje të rëndësishme për vete dhe për kombin, dhuntia e saj do ta detyrojë të largohet nga kështjella në minutën e fundit. Ajo do të bashkohet me një grup kolonësh të nisur drejt Saksonisë së sotme, një zone ende e pashkelur asokohe.

Kolonët udhëhiqen nga Kristiani, ka-

lorësi fisnik që magjepset nga bukuria dhe brishtësia e Martës dhe kthehet në njeriun e vetëm që mund të ndryshojë fatin e saj. Por urtësia dhe dhuntia e shëronjësës tërheqin edhe vëmendjen e Randolphit, armikut të përbetuar të Kristianit në oborr. Të dy do të ndeshen për pushtet dhe pasion, për drejtësi dhe nder.

"E fshehta e shëronjësës" është vëllimi i parë i sagës së shëronjësës, një vepër që na përball me personazhe të vërteta dhe imagjinare, me fate të trilluara dhe historike të kohës së perandorit Frederik Barbarosa.

"Gruaja e liqenit", Sara Gruen

Befasuese... një histori guximi, aventure, miqësie dhe dashurie gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Në janar të vitit 1945, Medlina Hajd dhe bashkeshorti i saj, Elisi, humbasin çdo të ardhur që merrnin nga familja e tij. Babai i Elisit, një kolonel në pension, ndihet i poshtëruar, ngaqë i biri është shpallur i paaftë për të shkuar në luftë. Elisi vendos se mënyra e vetme për të rifituar respektin e të atit është që të triumfojë atje ku ai ka dështuar: në kapjen e përbindëshit të famshëm të Lok Nesit.

Pasi arrin ta bindë të shoqen t'i shkojë pas, Elisi, Medlina dhe shoku i tij i ngushtë përfundojnë në një fshat të largët të Skocisë, banorët e të cilit i përçmojnë të huajt e çuditshëm. Gjatë ditës, kur Elisi dhe Henku janë në kërkim të përbindëshit,

Medlina mbetet vetëm në bujtinën e izoluar, ku ushqimi është me racion dhe çdo e trokitur e postierit mund të sjellë një ogur të keq. Megjithatë nuk kalon shumë dhe ajo bie në dashuri me bukurinë e rrallë dhe magjinë e fshatit skocez.

Pak nga pak, ajo zë miqësi me banorët e fshatit dhe kjo i hap horizonte të paeksploruara më parë. Pikërisht atëherë, fillon të kuptojë se asgjë nuk është ashtu si duket, madje duke nisur nga vetë jeta e saj. Në Skoci, Medlina Hajd kupton jo vetëm forcat e errëta që e rrethojnë, por edhe mundësitë e bukura që mund të të rezervojë jeta në çdo çast.



Dialogu pa konsensus sjell “Demarkacionin 2”

Demarkacioni apo shënjimi i vijës kufitare ndërmjet Kosovës dhe Serbisë do të jetë një proces i domosdoshëm për të dyja vendet. Përveç si nevojë për normalizimin e raporteve, demarkacioni pritet të jetë kusht i BE-së edhe në proceset integruuese për Kosovën dhe Serbinë.

Presidenti i Kosovës Hashim Thaçi pritet që së shpejti të takohet sërish me homologun e tij serb Aleksandër Vuçiq në kuadër të fazës finale të dialogut. Por, mosarritja e konsensusit të brendshëm për këtë fazë vlerësohet se mund t'ia sjellë Kosovës një skenar të ngjashëm me atë të bllokadës rreth Demarkacionit me Malin e Zi, shkruan sot Gazeta “Zëri”. Ndonëse takimi i tretë në kuadër të fazës finale të dialogut Kosovë-Serbi pritet të mbahet në fillim të muajit shtator partitë politike në Kosovë ende nuk kanë arritur një konsensus mbi këtë proces.

Mosarritja e një ujdje në këtë drejtim, para marrëveshjes finale



Kosovë – Serbi, mund t'ia rikthejë Kosovës skenarin e Demarkacionit. Kështu vlerësojnë monitoruesit e procesit të dialogut, të cilët thonë se për ta ratifikuar marrëveshjen përfundimtare me Serbinë nevojiten dy të tretat e votave të deputetëve, respektivisht 80 sosh, shkruan më tutje “Zëri”.

Në anën tjetër, Marrëveshja e Demarkacionit me Malin e Zi ia kishte humbur Kosovës rreth tre vjet derisa ishte miratuar në Kuvend, pasi që subjektet politike atëkohë nuk gjenin dakordim mbi këtë marrëveshje.

Për të mos u përsëritur ky skenar, sipas përfaqësuesve të pozitës,

arritja e një konsensusi të gjerë është më se i domosdoshëm. Porse, partitë opozitare po vazhdojnë ta kundërshtojnë fazën finale të dialogut në mënyrën si ka nisur, fazë kjo e cila po drejtohet nga presidenti i Kosovës Hashim Thaçi.

Demarkacioni apo shënjimi i vijës kufitare ndërmjet Kosovës

dhe Serbisë do të jetë një proces i domosdoshëm për të dyja vendet. Përveç si nevojë për normalizimin e raporteve, demarkacioni pritet të jetë kusht i BE-së edhe në proceset integruuese për Kosovën dhe Serbinë.

Bashkimi Evropian ua ka bërë të qartë të gjitha vendeve të Ballkanit Perëndimor më strategjinë e re të zgjerimit se nuk mund t'i bartin problemet dhe konfliktet e tyre brenda BE-së, dhe se ato duhet t'i zgjidhin para se të pretendojnë anëtarësimin gjatë viteve të ardhshme.


Kryetari i Komisionit Shtetëror për Shënimin dhe Mirëmbajtjen e Kufirit të Kosovës, Shpejtim Bulliqi, tha për Radion Evropa e Lirë se Kosova ka potenciale të mjaftueshme për t'iu qasur çështjes së demarkimit të kufirit me shtetin e Serbisë. Pas ratifikimit të Marrëveshjes për kufirin me Malin e Zi, proces ky që kishte zgjatur tre vjet, tani Kosovës i mbetet të rumbullakojë edhe shënjimin e vijës kufitare me Serbinë.

Serbia e synon 'ndarjen e Kosovës nëpërmjet Asociacionit

Pasoja të mëdha janë paralajmëruar në rast se Kosova pranon diskutimet për ndarje apo shkëmbim të territoreve, në kuadër të opsioneve për arritjen e një marrëveshjeje ligjërish të detyrueshme me Serbinë. Derisa takimi i radhës mes palëve është caktuar të mbahet në shtator, brenda Kosovës janë duke vazhduar përpjekjet për unifikimin e spektrit politik, shkruan Koha Ditore.

Edhe pse nuk është apostrofuar publikisht, ndarja territoriale vazhdimisht ka qenë pjesë e kalkulimeve të palës serbe, kanë vlerësuar njohës të rrethanave politike. Sipas politologut Belul Beqaj, Serbia e synon ndarjen përmes Asociacionit/Bashkësisë së komunave me shumicë serbe, për të cilin është duke insistuar që t'i vishen kompetenca ekzekutive.

Analizën e tij, Beqaj e mbështet veçmas pas deklaratave të presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq, i cili ka thënë se, tani amerikanëve u intereson edhe mendimi i tij për zgjidhjen e çështjes së Kosovës. Prandaj ndarja territoriale, siç ka thënë Beqaj, nuk përjashtohet nga vazhdimi i dialogut.



Dogana e Kosovës dhe ajo e Shqipërisë bashkohen në Morinë

Të martën (sot), pritet t'i jepet fund burokracisë doganore në mes të Kosovës e Shqipërisë. Po këtë ditë do të bëhet bashkimi i pikës doganore në Vermicë, e cila do të kalojë në Morinë, raporton KTV.

Qëllimi i këtij projekti, sipas Ministrisë së Financave, është lehtësimi i procedurave të kontrollit për bizneset, të cilat është dashur t'iu nënshtrohen kontrolleve të dy pikave doganore.

Projekti është financuar nga projekti IPA i Zyrës së Bashkimit Evropian në Shqipëri, ndërsa kontributi i Kosovës ka qenë vetëm plotësimi i nevojave për enterier në shumën prej rreth 30 mijë euro.

Përveç pikës doganore në Vermicë, sipas MF, unifikimi i doganave do të bëhet edhe në pikat tjera kufitare. Me këtë veprim pajtohen edhe përfaqë-



sues të bizneseve.

Kryetari i Odës Amerikane thotë se pas kalimit të mbledhjes së TVSH-së brenda shtetit, duke iu mundësuar lehtësira financiare, është i mirëpritur edhe unifikimi i doganave. Sipas të dhënave të doganës, Shqipëria zë vendin e parë ku Kosova eksporton.

Vetëm në gjashtëmuajorin e parë të këtij viti, eksporti i mallrave në Shqipëri është në vlerë të 28 milionë eurove, duke shënuar rritje për 20 për qind. Ndërsa, Shqipëria është vendi i gjashtë që fut sasi të mallit në Kosovë, që po ashtu ka shënuar rritje nga 69 në 81 milionë euro.

Serbia iu shet armë terroristëve

Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Kosovës shpreh shqetësimin e thellë mbi publikimin e dëshmiave bindëse nga organizatat kredibile ndërkombëtare, siç është Amnesty International se armatimi i prodhuar në shtetin serb vazhdon të përdoret nga disa shtete afrikane, të cilat bëjnë shkelje sistematike të drejtave të njeriut dhe madje përdoren edhe nga luftëtarët e organizatës terroriste Boko Haram.

Ministria e Punëve të Jashtme nëmërpjejt një komunikate, thër-



ret Komunitetin Ndërkombëtarë që të rrisë kontrollin, verifikimin dhe mbikëqyrjen e sjelljeve dhe veprimeve të tilla të shtetit serb në kontinen-

tin afrikane, të cilat në mënyrë të tërthortë i kontribuojnë abuzimeve të drejtave themelore të njeriut dhe kërcënimit serioz të paqes dhe sigurisë. “Ministria e Punëve të Jashtme vlerëson se publikimi i këtyre dëshmiave forcon bindjen se Serbia ka përdorur dhe po përdorë shitjen dhe faljen e armëve si mjet të diplomacisë për të joshur disa shtete jo-njohëse të Republikës së Kosovës në kontinentin afrikane, që mos të ndërmarrin një hap të tillë”, thuhet në komunikatë.

BE: Ne jemi aleatë dhe jo armiq të SHBA-së

Bashkimi Europian, marrë si shënjestër nga Uashingtoni për sektorin tregtar dhe monetar, ritheksoi statusin e aleatit historik dhe të afrimit me SHBA-në, gjatë samitit të G20-s së Financave në Buenos Aires, transmeton

Komisioneri Europian për Çështjet Ekonomike, Pierre Moscovici nënvizoi se vendet europiane dëshironin të mbanin statusin e aleatit dhe jo të armikut, duke

marrë shkas nga fjala e përdorur nga presidenti amerikan, Donald Trump, i cili i kishte cilësuar europianët si "armiq" duke kritikuar politikën e tyre monetare dhe pasi kërcënoi me mbitaksim të produkteve europiane.

"Bashkimi Europian nuk është përgjegjës për çekuilibrimet tregtare. Sulmi ndaj nesh është i papërshtatshëm", theksoi komisioneri europian. Njëzet vendet më

të industrializuara të planetit theksuan se rritja ekonomike botërore ishte solide, por e kërcënuar për një kohë të shkurtër (...) si pasojë e rritjes së trensioneve tregtare dhe gjeopolitike. Komunikata përfundimtare G20-s të Financave, që u mbledh të shtunën dhe të dielën në Buenos Aires, thekson nevojën për rirforcimin e dialogut dhe veprimeve për limitimin e rrezikut dhe rirforcimin e besimit.



SHBA-IRAN, PËRSHKALLËZOHET MË TEJ TENSIONI

Tensioni mes Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Iranit ka arritur në kulmin e tyre. Presidenti amerikan Donald Trump dhe ai iranian, Hasan Ruhani, kanë lëshuar kërcënime ndaj njeri-tjetrit. Në një postim në Twitter shefi i shtëpisë se bardhe tha se Irani do të vuajë pasojat si ato që nuk ka parë asnjëherë në histori nëse kërcënon SHBA.

"Drejtuar presidentit Ruhani, mos kërcënoni kurrë më SHBA kurrë, ose do të vuani pasojat që historia nuk ka parë kurrë më pare." Presidenti iranian Hasan Ruhani paralajmëroi të dielën presidentin amerikan Donald Trump lidhur me politikën armiqësore kundër Teheranit, duke thënë se Amerika duhet ta dijë se lufta me Iranin është nëna e të gjitha luftërave. "Nuk duhet të luani me bishitin e luanit, sepse do të pendohet, Amerika duhet ta dijë se paqja me Iranin është nëna e çdo paqeje dhe lufta me Iranin është nëna e të gjitha luftërave."

Irani po përballë me rritjen e presionit dhe sanksione të ashpra



pas vendimit të Trump për të tërhequr Shtetet e Bashkuara nga marrëveshja bërthamore.

Uashingtoni tani do të rivedosë sanksionet, pavarësisht kundërshtive nga Britania e Madhe, Franca, Kina, Rusia dhe Gjermania, që kanë nënshkruar

marrëveshjen e 2015.

Edhe sekretari amerikan i shtetit, Mike Pompeo, tha se regjimi iranian i ngjason më shumë mafias se sa një qeverie. Duke folur para një grupi iraniano-amerikanësh në Kaliforni, Pompeo denoncoi Rouhanin dhe ministrin e

jashtëm, Javad Zarif, që negocian marrëveshjen bërthamore.

Nga ana tjetër Teherani insiston se programi i tij bërthamor është tërësisht paqësor dhe respektimi i marrëveshjes është verifikuar nga Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë Bërthamore.

Rregulla të reja për ushtaret izraelite

Te "Rregullorja e Modestisë" në ushtrinë izraelite janë shtuar nene të reja, që i ndalojnë ushtaret femra të veshin bluza të bardha, të rrinë pa recipeta e të pinë duhan pranë ushtarëve meshkuj, në mënyrë që të shmangen tundimet për këta të fundit.

Urdhri ka krijuar pakënaqësi mes ushtarëve femra e mes shoqatave të grave, që fajësojnë ushtarët fetarë Ultra-Ortodoksë, të cilët janë shtuar në radhët, e ushtrisë e që duan të imponojnë këndvështrimet e tyre. Urdhri më ekstrem është ai i recipetave, sipas tyre, pasi nuk lejohen t'i heqin as kur shtrihen të flenë gjumë. Femrat nuk lejohen të veshin as bluza të bardha apo pantallona të shkurtra. Një instruktore femër, madje, ishte larguar nga reparti pasi ushtarët meshkuj kishin raportuar se nuk ndiheshin mirë në praninë e saj. Ushtria izraelite ka pasur rënie të numrit të ushtarëve në 30 vitet e fundit, pasi nuk kanë rekrutuar nënshëtetas me origjinë arabe, por numri i femrave është shtuar ndjeshëm.

Strategjia amerikane për të parandaluar ndërhyrjen e Ruisë në zgjedhjet e ardhshme

Zyrtarët po marrin masa për të parandaluar një përsëritje të ndërhyrjes ruse, të diktuar nga shërbimet amerikane të zbulimit gjatë zgjedhjeve të 2016-ës.

Siç njofton Zëri i Amerikës, ndër këto masa është edhe një sistem që lajmëron publikun për ndërhyrjet e huaja:

Asgjë nuk është më e shenjtë për demokracinë, se sa zgjedhjet e lira dhe të ndershme. Votuesit vijjnë me besimin se vota e tyre ka rëndësi. Por, kjo premisë është sulmuar që kur u zbulua se Rusia ndërhyri në zgjedhjet e 2016-ës. Ligjvënësit thonë se pjesa e parë e strategjisë është fillimi i sanksioneve. "I kemi vendosur sanksione Ruisë, si një mënyrë që të mbajë



përgjegjësinë. Për më tepër, po sigurohemi që mos ta përsërisin dot", tha Paul Ryan, kryetar i Dhomës së Përfaqësuesve.

Por, koha nuk premtion. Po afrohen me shpejtësi zgjedhjet e

mesmandatit që mbahen në muajin nëntor, kur votuesit gjykojnë për punën e një presidenti të ri, duke ruajtur, apo duke zëvendësuar ligjvënësit në Kongres.

"Ky amendament është reagi-

mi ynë, në partneritet me shtetet amerikane, për t'i përplasur derën në fytyrë ariut rus, apo çdo rreziku tjetër që synon të godasë integritetin e zgjedhjeve tona", tha Ligjvënësi demokrat Steny Hoyer.

Departamenti i Drejtësisë po paralajmëron tashmë publikun për ndërhyrjen e huaj në procesin zgjedhor. Në thelb të strategjisë është vigjilenca e votuesve. Zëvendësprokurori i Përgjithshëm, Rod Rosenstein, thotë se keqbërësit kibernetikë vendosën në objektivat 21 shtete amerikane gjatë zgjedhjeve të fundit.

"Nuk kemi prova se ndonjë qeveri e huaj ja doli mbanë të ndryshojë votën, por rreziku është real", deklaroi zoti Rosenstein.

Ndërkaq, kritikët e administratës fajësojnë Presidentin Trump për faktin që nuk krijoi një task force të posaçme, apo që nuk emëroi një drejtor të sigurisë kibernetike. Analistja Elaine Kamarck flet për rreziqet që sjell mosveprimi...

"...Do të na kontrollonte Rusia. Duke patur njerëz të cilët, me apo pa ndërgjegje, i janë mirënjohës një fuqie të huaj që nuk beson tek demokracia", thotë ajo.

Presidenti Trump thotë se administrata e tij po bën gjithçka të mundshme për të parandaluar ndërhyrjen e Ruisë në zgjedhjet që vijjnë. Kanë mbetur, megjithatë vetëm 100 ditë për të ndërtuar strategjitë për këtë qëllim. (VoA)

ZBULOHEK RECETA PËR BUKËN MË TË VJETËR NË BOTË

Merrni miell nga gruri dhe elbi i egër, përzijeni me pluhurin e rrënjëve të bimëve, shtojini ujë dhe pastaj piqeni. Sipas shkencëtarëve, kjo është receta për bukën më të vjetër në botë, që daton më shumë se 14.000 vjet.

Buka e pjekur ishte e sheshtë, jo e fryrë me maja dhe kishte pak shijen e bukës së sotme. Bukë ka qenë prej kohësh pjesë e dietës sonë kryesore. Por pak dihet për origjinën e bërjes së bukës.

Deri tani, dëshmia më e vjetër e bukës erdhi nga Turqia 9.000 vjet më parë. Gjetja e fundit, nga një vend arkeologjik në Shkretëtirën e Zezë në Jordani, shtyn përsëri provën e parë për bërjen e bukës për më shumë se 5.000 vjet, transmeton ATSH.

Shkencëtarët zbuluan dy ndërtesa, secila prej të cilave përmbante një oxhak të madh rrethor me gurë, brenda së cilës u gjetën thërrimet e bukës. Analizuar në mikro-



skop, mostrat e bukës treguan shenja të bluarjes, sitjes dhe përzijes. Dr Amaia Arranz-Otaegui i Universitetit të Kopenhagës, e cila zbuloi thërrimet e bukës, tha se kjo ishte gjëja e fundit që ata prisnin të

gjenin në vend. "Buka është një lidhje e fuqishme midis kulturave tona të së kaluarës dhe ushqimit të tanishëm,"-tha ajo. "Kjo na lidh me paraardhësit tanë prehistorikë." Buka është bërë në disa faza,

duke përfshirë bluarjen e drithërave ose zhardhokëve, përzijerjen e miellit me ujë për të bërë brumin dhe pjekjen e brumit në hirin e nxehtë të oxhakut ose në një gurë të nxehtë të sheshtë.



Frëngjishtja që do të dominojë botën

Ndonëse deri tani, dy janë gjuhët më të folura në botë, gjuha kineze, dhe anglishtja, duket se një gjuhë tjetër e cila sot numëron vetëm 284 milion folës në botë, do të zërë vendin e parë.

Sipas studimeve frëngjishtja do të zërë vendin e parë si gjuha me e folur në botë deri në vitin 2050 dhe kjo falë rritjes së shpejtë të popullsisë që e ka gjuhë zyrtare.

Deri tani frëngjishtja është gjuhë e zyrtare në disa vende të botës si Maroku, Tunizia, Algjeria, si dhe gati 30 vende të tjera, transmeton ATSH. Në Afrikë gjithashtu frëngjishtja është gjuha zyrtare e shkollimit në vende me norma fertiliteti të larta në rritje, si Mali në veri, Guinea Chad dhe Republika Demokratike e Kongos në rajonin sub-Saharian. Ndërkohë, Kina dhe shumë vende që flasin anglisht do të përballen me një tkurrje të popullsisë, që do të ulë numrin e anglishtfolësve në 3% të popullsisë së botës dhe ata që flasin gjuhën mandarine në 8% nga 10% që është aktualisht.



Efekti i aspirinës varet nga pesha e pacientit

Efekti i një aspirine në ditë përse i përket parandalimit të problemeve të caktuara shëndetësore, varet edhe nga pesha trupore e personit që e konsumon, sipas një studimi të publikuar në revistën "Lancet". Rezultatet e këtij studimi, ku përfshiheshin të dhënat e 10 studimeve të përzgjedhura rastësisht, tregojnë se doza e aspirinës dhe kilogramët e pacientit ndikojnë dukshëm në efikasitetin e ilaçit, transmeton ATSH. Një dozë ditore e aspirinës mes 75 dhe 100 miligramësh ul me 23% rrezikun nga veshitirësitet kardiovaskulare te personat me peshë deri në 70 kilogramë. Por, ky efekt nuk arrihet te personat me peshë mbi 70 kilogramë. Për uljen e rrezikut të vështirësive kardiovaskulare, tek personat që kanë peshë më të lartë se 70 kilogramë nevojitet një dozë ditore mes 325 dhe 500 miligramësh.

Rreziku nga Alzheimeri më i lartë te gratë me shumë fëmijë

Rreziku nga Alzheimeri mund të rritet për 70% te gratë që kanë pesë ose më shumë fëmijë, sipas një studimi.

"Një studim, në të cilin kanë marrë pjesë 3.500 gratë moshës mbi 60 vjeç në Korenë e Jugut dhe Greqi, ka treguar se mundësitë tek gratë që lindin pesë ose më shumë fëmijë të vuajnë nga Alzheimeri në pleqëri mund të jenë 70%, sipas CNN, transmeton ATSH.

Në studim është parë se gratë që nuk vuajnë nga demenca dhe kanë më shumë se pesë fëmijë kanë rezultuar më të pasuksesshme në testet konjiktive, krahasuar me gratë që kanë më pak se pesë fëmijë.

Studimi gjithashtu ka treguar se gratë që kanë



përjetuar një apo dy shtatzëni të paplota kanë shumë më pak gjasa për të zhvilluar Alzheimerin sesa gratë që nuk kanë qenë kurrë shtatzënë.

Neuropsikiatri Ki Woong Kim nga Universiteti Kombëtar i Seulit, tha se rritja në masë të madhe dhe rënia e menjëhershme e estrogenit dhe hormonit të stresit te gratë mund të jenë shkaktarë të rritjes së rrezikut të Alzheimerit, gjendje kjo që mund të ndikojë negativisht në aktivitetet e trurit.

Sipas Raportit Botëror të Alzheimerit për vitin 2016, në botë 47 milionë njerëz vuajnë nga demenca.

"Biblioterapia", të shëruarit me lexim

Harrojeni jogën! Ka një terapi të re, e mbase edhe të vjetër njëkohësisht, që po gjen çdo ditë më shumë përdorim të gjerë në botë për qëllime terapeutike.

Quhet "Biblioterapi" dhe është gjëja më e thjeshtë që mund të bëjmë të gjithë: të lexojmë!

Nuk ka nevojë për veshje të posaçme, për përgatitje, palestra, organizim të lodhshëm kohe. Librin e lexon kurdoqoftë, transmeton TCH.

Për herë të parë, "Biblioterapia" si term është përdorur në vitin 1916, në artikullin "Një klinikë letrare" të "Atlantic Monthly".

Autori fliste aty për një insti-



tut "bibliopatik" të ndodhur në bodrumin e një kishe, e të drejtuar nga një person i quajtur Bagster, në të cilin leximi reko-

mandohej për vlerat shëruese. "Biblioterapia është një shkencë e re", thoshte Bagsteri. "Një libër, - arsyetonte ai, - mund

të jetë stimulant ose sedativ, mund edhe të ngacmojë. Mund të jetë shurupi qetësues ose mustarda që djeg. Ai, me pak fjalë zgjon dhe përçon jetë të re në dejet tona". Sot "Biblioterapia" ka marrë formë të ndryshme, duke nisur nga kurset e literaturës në burgje, e deri te grupet e leximit për të moshuarit që vuajnë nga demenca. Ndonjëherë do të thotë seanca për ata që janë shkëputur prej kohësh e duan t'i rikthehen leximit, por mund të jetë mbase edhe më e thjeshtë sesa kaq.

Mjafton vetëm të uleni e të lexoni, për të mirën e mendjes dhe shëndetit tuaj.

LIGA E KAMPIONËVE, SHKËNDIJA PRET SHERIF TIRASPOLIN

ALIMI: ME PËRKRAHJEN E TIPOZËVE MUND TË MPOSHTIM SHERIFIN



PAS SHTATË VITEVE NAFIU RIKTHEHET TE SHKËNDIJA

Kuqezinjtë gjatë ditës së djeshme kanë bërë lëvizjen e radhës në merkato, duke firmosur me sulmuesin 24 vjeçar, Valmir Nafiun. Edhe pse tetovari ishte pranë transferimit në Rumania, Shkëndija reagon shpejtë dhe e bën atë të vetin deri në vitin 2020. Lojtari i dalë nga shkolla e Shkëndijës kthehet në klubin amë pas shtatë viteve, pasi ishte pjesë e Bazelit në Zvicër, Hamburgut të Gjermanisë, APOEL-it në Qipro, Skënderbeut të Shqipërisë dhe së fundmi Renovës. "E kam ditur gjithmonë se një ditë do të kthehem te klubi i zemrës Shkëndija. Është ndjenjë jashtëzakonisht e mirë, kështu që jam shumë i lumtur që jam këtu. Është interesat fakti se largimi im në vitin 2011 ishte kur Shkëndija doli kampione, ndërsa tani kthehem dhe sërish e njëjta situatë. Shkëndija përsëri kampione por në nivele shumë më të larta. E kam ndjekur thujtë çdo ndeshje Shkëndijën dhe është kënaqësi të luash duke pasur pas vetes tifozët e flaktë si që janë 'Ballistët' që mbështesin ekipin në çdo ndeshje. Tani që jam këtu premtoj se do të jap më të mirën nga vetja për të realizuar objektivat", u shpreh Valmir Nafiu menjëherë pasi zyrtarizoi marrëveshjen dy vjeçare.



"Ftoj tifozët të vijnë në numër sa më të madh, pasi ata janë forca shtyese e jona dhe me përkrahjen e tyre besojmë se do të japim më të mirën për të mundur skuadrën e Sherifit", pohon kapiteni i kuqezinjve

Koha

Bujar KURTAJ

Shkup, 23 korrik - Skuadra e Shkëndijës në kuadër të raundit të dytë në Ligën e kampionëve, sonte (e martë) me fillim në ora 20.15 në stadiumin "Filipi i dytë" do të përballlet me kampionin e Moldavisë, Sheriff Tiraspol. Pas arriti të eliminojë skuadrën nga Uellsit, TNS, djemtë e trajnerit Qatip Osmani vëmendjen e kanë rikthyer kah dueli i sotëm, një rival shumë më serioz, derisa, paralel me përgatitjen e lojës në bazë të kundërshtarit, stafi teknik lojtarëve u ka po-

tencuar eliminimin e gabimeve të shfaqura në përballjen e fundit në Uells ku kuqezinjtë pësuan disfatë prej 4-0. Trajneri Osmani pohon se djemtë e tij i pret një përballje e rëndë kundër kampionit të Moldavisë, Sheriff Tiraspol, megjithatë ai potencon se janë të gatshëm për sfidën që i pret, derisa numri një i kuqezinjve u ndal edhe në humbjen e thellë nga TNS në ndeshjen kthyesë në Uells. "Sigurisht se pas asaj humbje 4-0 në Uells nuk është njësoj. Gjatë ditëve të fundit kemi punuar në aspektin psikologjik me lojtarët, ndërsa me

disa prej tyre edhe individualisht. Jemi munduar ta sjellim situatën në gjendje normale për të rikthyer vetëbesimin. Jemi të gatshëm për këtë sfidë. Kundërshtarin e kemi analizuar mirë dhe bëhet fjalë për një skuadër kualitative. Jemi të gatshëm ti eliminojmë dhe të vazhdojmë tutje", deklaroi para mediave Osmani, i cili konfirmoi se në vend të Marjan Radeskit, ndaj Sheriff Tiraspolit do të luajë Remzifai Selmani. Në anën tjetër, kapiteni Armend Alimi ashtu sikurse ndaj TNS, edhe ndaj Sheriff Tiraspolit dëshiron fitore pa pranuar gol. "Ndaj Sheriff Tiraspolit

në ndeshjen e sotme si vendas dëshiroj fitore pa pranuar gol. Do të synojmë të luajmë lojën tonë më të mirë dhe në anën tjetër të ndalim sulmin e tyre, pasi sulmi është arma më e fortë e tyre. Ftoj tifozët të vijnë në numër sa më të madh, pasi ata janë forca shtyese e jona dhe me përkrahjen e tyre besojmë se do të japim më të mirën për të mundur skuadrën e Sherifit", deklaroi Alimi. Ndërkohë, nëse skuadra e Shkëndijës arrin që të kualifikohet në xhiron e tretë, atëherë ata do të përballen me skuadrën e Sallzburgut nga Austria.

EDHE NJË 16-TË VJEÇAR NËNSHKRUAN KONTRATË PROFESIONALE ME BARDHEKALTËRIT

FC Shkupi blindon portierin Jonuzi

Shkup, 23 korrik - Në fillim të muajit korrik, skuadra e FC Shkupit kishte arritur që të nënshkruaj kontratë profesionale me talentin 16 vjeçar që vjen nga shkolla e futbollit të klubit tonë, Suhel Muharemi, i cili tani është pjesë e ekipit të seniorëve dhe ka marrëveshje me klubin për tre vitet e ardhshme. Të njëjtën gjë të hënë klubi e ka bërë edhe me portierin Nuhi Jonuzi, i cili është gjithashtu në moshë 16 vjeçare, ndërsa kontrata e tij me Shkupin është tre vjeçare. Stafi i trajnerëve dhe kryesia e cilësojnë Jonuzin e shohin si një nga portierët e të ardhmes së klubit. Menjëherë pasi nënshkroi kontratën profesionale me bardhekaltërit, Jonuzi u shpreh i lumtur dhe pranoi se kjo ia shton vullnetin atij që të punojë edhe më shumë. "Jam i lum-



tur nga klubi për kushtet që më ofruan dhe për kontratën profesionale. Mendoj se ky është një

hap shumë i madh për mua që tani në këtë moshë të kem kontratë profesionale e që sigurisht

SHKUPI KUNDËR BALLKANIT DHE FERONIKELIT

Pas përfundimit të aventurës evropiane, skuadra e FC Shkupit të hënë i është rikthyer punës me përgatitje për fillimin e kampionatit të Ligës së Parë të Maqedonisë, që planifikohet të fillojë me 5 gusht. Trajneri Zekirja Ramadani u kishte dhënë pesë ditë pushim futbollistëve, që dje në orët e mëngjesit të kryejnë seancën e parë stërvitore në fitnes, ndërsa në orët e pasdites realizuan seancën e dytë stërvitore në fushën e stadiumit të Çairit. Në anën tjetër, klubi do të ketë edhe dy ndeshje kontrolluese, fillimisht do të luajë ndaj ekipit të FC Ballkani nga Suhareka në stadiumin e Çairit me 25 korrik në ora 17.00, ndërsa katër ditë më vonë gjithashtu në stadiumin e Çairit në ora 17.00 FC Shkupi do të përballlet me Feronkelin nga Drenasi, që llogaritet si një ndër klubet më të organizuara në kampionatin e Kosovës.

më shtonë vullnetin për të punuar edhe më shumë, që në të ardhmen sa më të shpejtë të jem në mes shtyllave të portës për Shkupin. Kjo sigurisht që do të ndikojë shumë edhe të talentet tjerë që të japin maksimumin që nesër të arrijnë të jenë pjesë e ekipit senior", tha përfaqësuesi i klubit por-

tieri Jonuzi. Të përkuqtojmë se Jonuzi tani disa vite është portier i tretë i skuadrës, duke qenë me ekipin e seniorëve në të gjitha kompetet stërvitore, ndërsa ishte në mesin e portierëve edhe në ndeshjen e "Europa League" në ndeshjen e kthimit në Shkup ndaj Glasgow Renxhers.

MIGJEN BASHA DY VITE TE ARISI

Bashkë do të bëjmë më të mirën për klubin

Migjen Basha mund të konsiderohet zyrtarisht futbollisti më i ri i Arisit të Selanikut. Pasi i përfundoi kontrata me Barin, mesfushori i kombëtares kuqezi ka vendosur ta vazhdojë karrierën në kampionatin grek te skuadra e sapongjitur në futbollin helen. Entuziazëm i madh në radhët e tifozëve të Aris për transferimin e Bashës në Selanik. 31-vjeçari është pritur në aeroport nga një grup tifozësh ultras të Arisit madje njëri prej tyre mbante veshur fanelën e klubit selanikas me emrin e Kristi Vangjelit mbi shpinë për t'i uruar mirë-

seardhjen një tjetër futbollisti shqiptar. Vangjeli ka lënë shenjë në periudhën që ka luajtur për skuadrën selanikase dhe të njëjtën gjë do të kërkojë të bëjë edhe Basha. "Do të jap 200 për qindëshin për ekipin dhe të gjithë bashkë të bëjmë më të mirën për klubin. Ka mbetur vetëm vizita mjekësore por gjithçka është në rregull, nesër është firma", ishin fjalët e para të Bashës. Gjatë ditës së djeshme pritej që Basha të firmosë zyrtarisht edhe kontratën që do ta lidhë me Arisin për dy sezonet e ardhshme.



Publicitet

Në bazë të nenit 21 dhe 22 të Ligjit për punësuarve në sektorin publik dhe nenit 22 dhe 23 prej Ligjit të marrëdhënies të punës, Agjencia e Punësimit e Republikës së Maqedonisë, boton

Shpallje

për punësim me kohë të caktuar deri me 31.12.2018

IPër nevojat e themelimit të marrëdhënies së punës për kohë të caktuar në Agjencinë e Punësimit të Republikës së Maqedonisë për vendin e punës siç vijon:

1. Bashkëpunëtor shërbimeve për mbështetjen e punësimit në Agjencinë e Punësimit të Republikës së Maqedonisë – Qendra e punësimit në qytetin e Shkupit-(1) një realizues;

Kandidati duhet t'i plotësojë edhe kushtet e veçanta siç vijojnë:

- Arsimin e lartë, përkatësisht të ketë së paku 180 kredit të arritura sipas ECTS-së ose të ketë mbaruar shkallën VII/1;
- Të ketë së paku dy vjet përvojë pune në profesion;
- Të ketë njohje aktive të programeve kompjuterike për punë zyre;
- Të ketë njohje aktive të njërit prej tri gjuhëve që më së shpeshti përdoren në Unionin Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht);
- Rroga themelore neto për vendin e punës do të jetë 23.230,00 denarë

Bashkë me fletëparaqitjen kandidatët duhet të dorëzojnë edhe:

- Dëftesën/diplomën për mbarimin e nivelit arsimor;
- Vërtetimin/dëshminë për përvojë punës;
- Vërtetimin/dëshminë për njohje e programeve kompjuterike për punë zyre;
- Vërtetimin/dëshminë për njohje aktive të gjuhëve;
- Dëshminë se nuk është shqiptuar ndalesë për ushtrimin e profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
- Vërtetimin e shtetësisë

II. Marrëdhënia e punës themelohet me orar të plotë pune-40 orë në javë, nga e hëna deri të premten, ndërsa orari i punës ditore është prej 07:30 deri 15:30.

III. Bashkë me fletëparaqitjen, kandidatët duhet të dorëzojnë dëshmi me të cilat vërtetohet plotësimi i kushteve të parapara.

IV. Shpallja do të jetë e hapur pesë ditë pune, duke filluar nga data e botimit në shtypin ditor.

V. Fletëparaqitjet me dokumentacionin e nevojshëm duhet të dorëzohen në arkiv nëpërmjet postës në adresën siç vijon: Agjencia e Punësimit e Republikës së Maqedonisë- shërbimi qendror, rruga "Vasil Gjorgov" nr. 43, Shkup.

Në bazë të nenit 126 pika 1 alineja 7, nga Ligji për arsim fillor (Gaz. Zyrtare e R.M. nr. 103/2008, 33/2010, 116/2010, 156/2010, 18/2011, 42/2011, 51/2011, 6/2012, 100/2012, 24/2013, 41/2014, 135/2014, 10/2015 98/2015, 145/2015, 30/2016, 127/2016 dhe 67/2017), neni 79 pika 1 alineja 7 nga Statuti i shkollës, si dhe Vendimit të sjellur nga mbledhja e Këshillit të shkollës me nr. 0201-368/1 e datës 20.07.2018 vit, Këshilli i Sh.f.k."Luigi Gurakuqi"-Zhelinë, Komuna e Zhelinës, publikon:

SHPALLJE PUBLIKE PËR EMËRIM TË DREJTORIT TË SHKOLLËS

Përveç kushteve të përgjithshme të parapara me Ligj, kandidati duhet t'i plotësojë edhe kushtet e veçanta të parapara në bazë të nenit 128 pika 3 nga Ligji për arsimin fillor:

- Të ketë së paku arsimim të lartë dhe t'i plotësojë kushtet për arsimtar ose bashkëpunëtor profesional në shkollë fillore,
 - Të ketë së paku 5 (pesë) vjet përvojë pune në procesin edukativo-arsimor,
 - Të ketë dhënë provimin për Drejtor,
 - Me vendim fuqiplotë gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ose sanksion për shkelje e cila l'a ndalon kryerjen e profesionit, aktivitetit ose detyrës.
 - Të ketë certifikatë adekuate jo më të vjetër se 5 (pesë) vjet për njohjen e gjuhës angleze TOEFL IBT – së paku 30 pikë, IELTS – së paku 3 pikë, BULATS – së paku 20 pikë ose KET (Cambridge English) të dhënë.
 - Të ketë dhënë testin psikologjik dhe testin për integritet.
- Kandidatët së bashku me kërkesën duhet t'i dorëzojnë këto dokumente të nevojshme:
- Fletëparaqitje për konkurs,
 - Vërtetim/Diplomë për kryerjen e shkollimit të lartë,
 - Vërtetim me së paku 5 (pesë) vite përvojë pune në procesin edukativo-arsimor,
 - Vërtetim nga Gjyqi se nuk i është shqiptuar dënim ose sanksion për shkelje e cila l'a pamundëson kryerjen e profesionit në punën edukativo-arsimore,
 - Vërtetim për dhënie e provimit për Drejtor (nëse nuk ka provim të dhënë për Drejtor, obligohet që në afat prej 1 (një) viti nga dita e emërimit ta jep provimin për Drejtor),
 - Certifikatë për nënshkretësi,
 - Certifikatë e lindjes,
 - Certifikatë mjekësore,
 - Biografi të shkruar (CV),
 - Program për punën 4 (katër) vjeçare,
 - Certifikatë për njohjen e gjuhës angleze.

Konkursi zgjat 8 (tetë) ditë nga dita e shpalljes në gazetën ditore. Kërkesa së bashku me dokumentacionin e kompletuar të dorëzohet në adresën: Sh.f.k."Luigi Gurakuqi" – f.Zhelinë, Komuna e Zhelinës (Këshilli i Shkollës).

Dokumentet e pa kompletuara si dhe ato të cilat arrijnë pas afatit të parapara në shpallje, nuk do të merren në shqyrtim.

Kryetari i Këshillit të Shkollës
AKI ZIBERI

Në bazë të nenit 30 të Statutit të IP SH Klinika universitare për sëmundje kirurgjike "Sv. Naum Ohridski" – Shkup, nenit 21 paragrafi 3 dhe nenit 22 paragrafi 1 alineja 2 të Ligjit për të punësuarit në sektorin publik ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 27/14, 199/14, 27/16 dhe 35/18) Lajmërimin për mjetet e siguruar financiare nga Ministria e financave nr. 18-8047/2 të datës 16.07.2018 dhe Vendimit për nevojën për punësim të nëpunësit administrativ përmes publikimit të shpalljes publike nr. 02-2342/1 të datës 23.07.2018 nga U. D Drejtori medicinal, IP SH Klinika universitare për sëmundje kirurgjike "Sv. Naum Ohridski" – Shkup publikon

SHPALLJE PUBLIKE

për punësim të nëpunësit administrativ për kohë të caktuar në IP SH Klinika universitare për sëmundje kirurgjike "Sv. Naum Ohridski" – Shkup

1. **IP SH Klinika universitare për sëmundje kirurgjike "Sv. Naum Ohridski" – Shkup** ka nevojë për punësim për kohë të caktuar, me orar të plotë të punës të **1 (një) Udhëheqësi për punë materiale-financiare dhe kontabilitetit**

2. Kandidatët duhet ti plotësojnë kushtet në vijim edhe atë:

Kushtet e përgjithshme

- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë.
- të përdorë në mënyrë aktive gjuhën maqedonase
- të jetë i moshës së rritur,
- të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore, dhe
- të mos jetë të shqiptuar me vendim të plotfuqishëm ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet e posaçme:

- Shkalla dhe lloji i arsimit: niveli i kualifikimeve VI A sipas kornizës së Maqedonisë të kualifikimeve dhe së paku 240 kredit sipas SETK apo të mbaruar shkalla VII/1 – Shkencat ekonomike, certifikatë për kontabilist të autorizuar.
- Përvoja e punës: së paku pesë vjet përvojë pune në profesion nga të cilat së paku dy vjet në vend udhëheqës të punës në sektorin publik, gjegjësisht së paku tetë vjet përvojë pune në profesion nga të cilat së paku tre vjet në vend udhëheqës të punës në sektorin privat.
- Kompetencat e përgjithshme të punës: mësim dhe zhvillim, komunikim, realizim të rezultateve, punë me të tjerët/punë ekipore, vetëdije strategjike, orientim ndaj palëve/palët e involvuara dhe udhëheqje dhe menaxhim financiar.
- Kompetencat e posaçme të punës: njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë dhe njohje aktive të një prej tri gjuhëve më shpesh të përdorura në Bashkimin Evropian (angleze, frënge, gjermane).

3. Orari i punës 40 orë në javë , prej ditës së hënë deri ditën e premte, prej ora 07,30 deri në ora 15,30.

4. Neto pagesa bazë është 25.801,00 denarë

5. Me fletëparaqitjen kandidatët janë të obliguar ti dorëzojnë dokumentet në vijim


- Fletëparaqitje me të dhëna për kontakt
- Biografi të shkurtë (CV)
- Diplomë ose Certifikatë për arsimin e mbaruar, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter,
- Certifikatë për kontabilist të autorizuar, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter,
- Dëshmi për përvojë pune, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter,
- Dëshmi për njohje të gjuhës së huaj, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter,
- Certifikatë të shtetësisë së Republikës së Maqedonisë, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter,
- Certifikatë të mjekut aftësinë e përgjithshme shëndetësore, jo më të vjetër se 6 muaj, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter,
- Certifikatë se nuk është shqiptuar ndalesë e plotfuqishme për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter,
- Certifikatë për punë me programet kompjuterike për punë në zyrë, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter,

Kandidatët të cilët kanë mbaruar arsimin jashtë vendit përveç dokumenteve të lartpërmendura duhet të dorëzojnë:

- Vendim nga Ministria e arsimit dhe shkencës së RM për njohje të kualifikimit arsimor të arritur jashtë vendit

- Afati për paraqitje në shpalljen publike është 5 (pesë) ditë pune nga dita e publikimit.
- Dokumentacioni i dorëzuar pas afatit, i pakompletuar dhe i parregulluar nuk do të merret parasysh nga ana e komisionit për selektim të kandidatëve.
- Fletëparaqitja së bashku me tërë dokumentacionin e nevojshëm dhe të dhënat për kontakt, të dorëzohen në arkivin e IP SH Klinika universitare për sëmundje kirurgjike "Sv. Naum Ohridski" – Shkup, rr. 11 Oktomvri nr. 53 Shkup, ose përmes postës me shenjë "Për shpallje publike për punësim".

IP SH Klinika universitare për sëmundje kirurgjike "Sv. Naum Ohridski" – Shkup



**Republika e Maqedonisë
Komuna e Sopištes**

Tel: ++389 2 27 85 100
Faks: ++389 2 27 85 109
Rr. 2, Nr 2, f. Sopište, 1054
Shkup, Republika e Maqedonisë
www.opstinasopiste.gov.mk

Nr. i procedurës: **14737**
Nr. **28-23/18** nga **19.07.2018**

LAJMËRIM

Për organizim të Anketës dhe prezantimit publik për **Projektin arkitektonik-urbanistik për PK 1649/3, KK Sopište, Komuna e Sopištes**.

Bëhet prezantim dhe anketë publike për **Projektin arkitektonik-urbanistik për PK 1649/3, KK Sopište, Komuna e Sopištes**. Përfshirja planore dokument për **Projektin arkitektonik-urbanistik për PK 1649/3, KK Sopište, Komuna e Sopištes** është me sipërfaqe prej **500 m²**.

5. Prezantimi dhe anketa publike do të realizohet me prezantimin e planit në lokalet e Komunës së Sopištes më datë **26.07.2018 në ora 11.30**.

6. Anketa publike do të zgjasë deri më **03.08.2018**, në bazë të nenit 51 paragrafi 10 të Ligjit për Planifikim hapësinor dhe urbanistik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 199/14, 44/15, 193/15 dhe 31/16).

7. Informohen të gjithë qytetarët dhe subjektet e interesuara juridike nga rajoni konkret të përfshirë me planin në afatin e lartpërmendur të dorëzojnë vërejtje, propozime, mendime në listat anketuese në administratën komunale.

8. Informata në tel. 2 785 102

Kryetari i Komunës Sopište
Stefçe Trpkovski

URGJENTISHT

Shes truall të urbanizuar 890 m2 me markë ndërtimore 430 m2, lartësia 8,5 m, Bo + Pr + 1 + Nën, trualli i parë në "Momin Potok" – Shkup, industria e lehtë, asfalt, ndriçim të rrugëve, autobus, rrymë elektrike, ujë, kanalizim, telefon, internet, gardh, parking dhe nënobjekte të ndërtuara ndërtimore (gjithsej 180 m2). Çmimi 165.000 euro. Tel. 078-201-960

SIPAS "FOURFOURTWO" //

OBLAK, PORTIERI MË I MIRË NË BOTË

Pas Oblak, më i frikshmi është "gardiani" i Spanjës, David de Gea, si portieri i dytë më i mirë në botë. Me siguri, spanjollit gjendet në këtë vend falë paraqitjes e Mançester Junajted, teksa në Kupën e Botës së kësaj vere ishte një zhgënjim. Në vendin e tretë të këtij podiumi është belgu Tibaut Kurtoa, me paraqitje të shkëlqyer në Botërorin e Rosisë



Oblak, portierin sloven të Atletico Madrid. Mark-Andre ter Shtegen, portieri i Barcelonës, ka njëfarë ngushëllimi në këtë rast, sepse pozicionohet i katërti, edhe pse ishte zëvendësues (i përjetshëm) i Manuel Nojer në ekipin kombëtar

gjerman, në Botërorin e Rosisë. Portieri i Bajern Munihut zë vendin e tetë në këtë klasifikim, sipas këtij mediumi. Pas Oblak, më i frikshmi është "gardiani" i Spanjës, David de Gea, si portieri i dytë më i mirë në botë. Me siguri, spanjollit gjen-

det në këtë vend falë paraqitjes e Mançester Junajted, teksa në Kupën e Botës së kësaj vere ishte një zhgënjim. Në vendin e tretë të këtij podiumi është belgu Tibaut Kurtoa, me paraqitje të shkëlqyer në Botërorin e Rosisë, çka e sheh atë në rrugën e transferimit te Real Madridi. Pas Ter Shtegen, në vendin e katërt të kësaj renditjeje, shfaqet emri i brazilianit Alisson, një transferim rekord për një portier, pasi kaloi nga Roma te Liverpooli për 75 milionë euro. I gjashti është legjenda italiane, Xhanluigji Buffon, ish-portieri i Juves, tani te PSZH, ndërsa i shtati është braziliani Ederson, "gardiani" i Mançester Sinit. Për "FourFourTwo", i nënti është francezi i Totenhemit, Hugo Lloris, i cili pavarësisht gabimeve në finalen e Kupës së Botës, ishte një nga pikat referuese të ekipit të tij kombëtar. "Top 10" mbyllet nga sloveni i Interit, Samir Handanoviç.



Duhet ta rrisë ofertën për ta marrë Vidalin

Interi duhet ta rrisë ofertën e tij nga 20 milionë euro në 30 milionë euro për të bërë të mundur marrjen e Arturo Vidal, sipas "Bild". Skuadra e Seria A thuhet se ka dërguar një ofertë fillestare të Bajern Munihut, në shumën e 20 milionë eurove për mesfushorin kilen, kontrata e të cilit në "Allianz Arena" skadon verën e ardhshme. Por gjigandët bavarezë po vazhdojnë të kërkojnë më shumë, me rivalët e Interit, kuqezinjët e Milanit, gjithashtu të interesuar për kilianin. Në këtë mënyrë, rivaliteti nga Milano për Vidalin është i dukshëm, çka e bën Bajern Munihun të mos lëkundet në kërkesat fikse financiare për futbollistin e vet. Tashmë mbetet në dorë të zikaltërve për ta rritur edhe me 10 milionë euro ofertën e tyre, nëse duan ta bëjnë të tyrin mesfushorin tepër luftarak, që ka provuar të luajë suksesshëm në Seria A me Juventusin.

Uillian nuk është në shitje

"Mundo Deportivo" ka raportuar se deri më tani nuk ka pasur një takim midis agjentëve të Uillian dhe drejtuesve të Barcelonës. Që në fillim kur Barcelona shprehur interes për brazilian, presidenti i "bluve të Londrës" u shpreh se: "Uillian nuk është në shitje". Kjo gjë është përforcuar edhe më shumë me nënshkrimin e Maurizio Sarrit, i cili i tha presidentit: "Uillian dhe Hazard për mua

janë të paprekshëm". Por mesa duket sulmuesit brazilian nuk është se i pëlqen dhe aq tekniku i ri dhe këmbëngul që të vesh fanellën e Barcelonës. Përveç se do të luajë në një nga klubet më të mëdha, braziliani do të ketë shansin të luajë në "Champions League", gjë që Çellsit nuk mund t'ia ofrojë. Merkato në Angli përfundon më 9-të gush pikërisht në këtë ditë Uil-

lian feston ditëlindjen e 30-të. Mundësia që Çellsit ti hap derën Uillian është nënshkrimi me rusin Aleksandr Golovin dhe francezin Antoni Martial. Barcelona ka kohë edhe dy javë për të nënshkruar me brazilianin. Aktualisht sulmuesi është duke shijuar pushimet dhe duke pritur për transferimin e tij pasi deklaroi se dëshiron të transferohet tek Barcelona.



NË RAST SE LARGOHET PJANIÇ //

Juventusit do të tentojë ta rikthen Pogban



Juventusit është i vendosur të provojë gjithçka për të nënshkruar me Pol Pogba, nëse Miralem Pjaniç largohet. Kështu bën me dije në numrin e djeshëm sportivja torineze, "Tuttosport". Fantazisti boshnjak është lidhur me një lëvizje drejt Barcelonës, ose te Mançester Siti, kësaj vere, dhe nëse kjo ndodh, atëherë do të lërë një boshllëk të madh në mesfushën bardhezi. Juventusit do të përpiqet ta mbushë atë boshllëk me yllin e Mançester Junajtedit, Pogba, ndërsa Adrien Rabiot dhe Sergej Milinkoviç-Saviç, gjitha-

shtu, do të ishin opsione. Për francezin do të ishte një rikthim, i dëshiruar prej tij, sepse shkëlqeu me "Zonjën e Vjetër", arriti çmimin rekord të transferimit në "Old Trafford". Ai kaloi një sezon problematik, me një raport jo të mirë me trajnerin Hoze Murinjo, ndaj në Torino do të gjente qetësinë për të punuar dhe dhënë më të mirën e tij. Të luajturit përkrah Kristiano Ronaldos është një shtytësë më e madhe për rikthimin e Pogbas te Juventusit, gjë që është pranuar publikisht nga vetë kampioni i botës me Francën.

Silva, alternativ për sulmin e Napolit

Ana e djathtë e mbrojtjes është prioriteti për të zëvendësuar lamtumirën e Magjos, por te Napoli prishmëritë janë të gjitha për një sulmues të mundshëm. Edhe nëse ëndrra e popullit napoletan mbetet Edinson Kavani, duket se kjo pistë është e destinuar të mbetet kështu. "Unë mendoj se Paris Sen Zhermeni e vlerëson pothuajse 60 milionë euro, kur unë ia kam shitur për 63 milionë. Kurrë nuk do të lejoj që parisienët të rimarrin thujse atë shumë tani", janë këto fjalët e Aurelio De Laurentiis, i cili duke folur për "Kiss Kiss Napoli" nuk bëri asgjë për pritshmëritë e tifozëve, duke preferuar një "banjë të shëndetshme" për ta. Sidoqoftë, diçka në sulm mund të ndodhë, edhe pse, së pari, Ançelotti duhet të vlerësojë me kujdes gjendjen fizike të Milik. Emrat alternativë nuk mungojnë: nga Rodrigo, lojtari i Valencias, i përkufizuar si "një profil i bukur" nga De Laurentiis, deri te Andre Silva. Sipas edicionit të sotëm të "Corriere dello Sport", portugezi i Milanit, mbas sezonit të parë italian shumë më poshtë pritshmërive të përgjithshme, i është ofruar



Napolit. Ish-sulmuesi i Portos është një profil, që pëlqehet nga Giuntoli, edhe nëse nuk ka negociata mes dy klubeve. Gjithashtu, anglezët e Vulverhempton, siç dihet, janë në garë.

HENESS I LUMTUR PËR DORËHEQJEN E OZILIT

Heness thotë se largimi i yllit të Arsenalit duhet të mirëpritet, pasi ai ka qenë duke u larguar me performancat në nivelin mesatar për disa kohë



Presidenti i Bayern Munihut, Uli Hennes, është i lumtur që Mesut Ozil ka dalë në pension nga skuadra kombëtare e Gjermanisë, duke pretenduar se mesfushori-sulmues ka qenë një "sh*t" për vite me radhë. 29-vjeçari njoftoi se po largohej nga ekipi kombëtar me efekt të menjëhershëm për shkak të kritikave me të cilat u përball, pasi u shfaq në një foto me presidentin e Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan, së bashku me bashkëlojtarin, Ilkaj Gundogan, përpara fillimit të Kupës së Botës në Rusi, ku Gjermania ishte një zhgënjim total, sepse u eliminua që në fazën e grupeve. Presidenti i Federatës Gjermane të Futbollit (DFB), Reinhard Grindel, tha se Ozil iu detyrohej tifozëve me një shpjegim për incidentin, ndërsa menaxheri i ekipit kombëtar, Oliver Bierhoff, tha se Joakim Lev mund ta kishte lënë atë jashtë listës prej 23 lojtarësh për Botërorin e kësaj vere.

Ozil hodhi poshtë ndjesën të dielën, kur lëshoi deklaratën në mediat sociale: një duke shpjeguar fotografinë me Erdogan dhe një tjetër duke u përplasur me kritikët, përpara se të zbulonte vendimin e tij. Ylli i Arsenalit thotë se ai ishte bërë "kokë turku", se angazhimi i tij ndaj Gjermanisë ishte vënë në pikëpyetje për shkak të trashëgimisë së tij turke. Por Hennes thotë se largimi i yllit të Arsenalit duhet të mirëpritet, pasi ai ka qenë duke u larguar me performancat në nivelin mesatar për disa kohë. "Unë jam i kënaqur që kjo histori është mbyllur. Ai kishte qenë duke luajtur si "sh*t" me vite,

— tha presidenti i Bayern Munich për "Sport Bild". — Ai bëri një paraqitje të mirë para dhe gjatë Kupës së Botës 2014. Më pas, performanca e tij ka qenë një "sh*t", çka nuk mund të fshihet me foton e bërë me Erdogan. Kurdo që Bayern Munich ka luajtur kundër Arsenalit, ne jemi fokusuar mbi të, sepse e dinim se ishte pika e tyre e dobët. 35 milionë ndjekësit e tij, që nuk ekzistojnë në botën reale, janë të bindur se ai ka luajtur jashtëzakonisht dobët me Gjermaninë", deklaroi Hennes. Dhe nga një pikëpamje sportive, Ozil nuk ka vend në ekipin kombëtar për vite". Ozil bëri debuti-

Merkel reagon për kritikën ndaj Ozilit

Pas kritikave që mori gjatë Botërorit nga tifozët dhe jo vetëm, ditën e diel, mesfushori turko-gjerman, Mesut Ozil zyrtarizoi largimin nga kombëtarja gjermane. Ndërkohë, kancelaria Angela Merkel edhe pse jo zyrtarisht ishte kundër sjelljeve të tifozëve gjerman ndaj Ozil. Ajo është munduar që të qetësojë të gjithë opinionin publik, teksa i ka dalë dhe në mbrojtje të 29-vjeçarit. "Nuk mendoj që ofendimet dhe duartrokitjen na çojnë shumë larg, duhet të mundohemi t'i shikojmë gjërat me qetësi. Pres që lojtarët të duartrokiten dhe jo të ofendohen nga tifozët", tha kancelaria gjermane.



min e tij te Gjermania nën drejtimin e Joakim Lev në shkurt të vitit 2009 dhe luajti në total 92 ndeshje, duke shënuar 23 gola.



Kasillas i del në mbrojtje Kariusit

Loris Karius, i cili ka bërë disa gafa gjatë sezonit me Liverpoolit, duke mos harruar finalen e "Champions League", ku pësoi 3 gola nga Real Madridi, urrehet shumë nga tifozët e "kuq". Shumë tifozë kanë reaguar shumë keq me komente nga më të ndryshme duke ofenduar Karuis. Teksa të gjithë i janë vërsulur portierit gjerman në mbrojtje i ka dalë legjenda e Real Madrid, Iker Kasillas me anë të një mesazhi ku thuhet: "Ka probleme të tjera më serioze në botë, ta haj drejt! Lëreni djalin të qetë! Ai është një person. Siç jemi të gjithë ne", ka thënë Kasillas.

Parma qëndron në Serie A

Parma pak ditë më parë është përfshirë në një skandal për kurdishje ndeshjesh, teksa bëri që prokuroria italiane të niste hetimet për përballjen, Specia-Parma. "Gazzetta dello Sport" ishte e para media italiane që raportoi lidhur me këtë çështje, pasi klubi rrezikonte që të binte përsëri në Seria B, pas ngjites së fundmi në Seria A. Ndërkohë, mësohet se ditën e djeshme Gjykata Federale Italiane ka dhënë vendimin që bën me dije se Parma do të qëndrojë në Seria A, me një penalizim prej pesë pikësh, por ka dënuar rëndë me dy vite squalifikim sulmuesin Emanuele Kalcaio edhe me 20 mijë euro gjobë. Sulmuesi i Parmës, Kalcaio ishte pikërisht ai që u kishte çuar disa mesazhe të dyshimta disa lojtarëve të Specias në "What's up" duke u kërkuar të mos luanin fort në ndeshjen e fundit të sezonit në Serie B ndaj Parmës.

NJË MREKULLI EVËRTETË

Varka e Koentraos shpëton 15 peshkatarë



Pavarësisht se po kalon periudhën më të keqe në karrierën e tij si futbollist, Fabio Koentrao kësaj radhe është bërë hero duke arritur fitoren më të madhe në jetën e tij. Sipas mediave portugeze bëhet me dije se varka e quajtur "Victoria Coentrao" ka shpëtuar jetën e 15 peshkatarëve, që ishin duke u mbytur, teksa shkonin drejt Aviero. "Correio da Manhã" shkruan se për ngjarjen me peshkatarët, varka e cila po mbushej me

ujë dhe vetëm ndërhyrja e varkës së mbrojtësit ka bërë që ata të shpëtojnë të gjithë për mrekulli. Kapiteni i varkës ka qenë vëllai i lojtarit, teksa është treguar i zoti, duke gjetur pozicionin për t'i marrë peshkatarët e rrezikuar në bord. Ky gje-st prej një heroi të vërtetë padyshim që është një kënaqësi e madhe për të dhe për familjen e tij, duke ditur se edhe familja e tij vjen nga një familje peshkatarësh.



IDHA DORËN NJË FEMRE NË BOTËROR

Feghani në qendër të kritikave në vendin e tij

Arbitri iranian Alireza Faghani është vënë në qendër të kritikave në vendin e tij, pasi në Botërorin rus ai është fotografuar duke i dhënë dorën dhe përqaftuar një femër që nuk dihet kush është. Sipas ligjit islamik të Iranit është e ndaluar që një burrë të prekë një femër të panjohur, përveç ndonjë rasti urgjent. Faghani gjykoj katër ndeshje në Botëror, madje mori edhe medalje bronzi, pasi gjykoj "fina-

len" e vogël, atë mes Anglisë dhe Belgjikës. Dhënia e dorës ndaj një femre është cilësuar si një sjellje e shpifur dhe imorale nga konservatorët iranian. Por, vetë gjyqtari në fjalë e ka cilësuar këtë si një veprim krejt normal, pasi deklaroi se e nje-gruan në fjalë prej 5 vitesh, po ashtu edhe bashkëshortin e saj që është një mik i ngushtë i tij, po gjyqtar edhe ai. "Nuk e kuptoj këtë. Ajo më përgëzoi për gjykimin që bëra

unë. Nëse ata vazhdojnë të më kritikojnë për këtë, ju them që tani se do largohem. Do marr gruan dhe fëmijët e mi dhe do iki", tha Faghani. Irani është ndër ato vende që nuk lejon që femrat të shohin ndeshje në stadium bashkë me meshkujt. Vetëm disa muaj më parë femrave iu dha e drejta për të shkuar në stadium. Pas 40 vjetësh femrat iraniane ndoqën në stadium një ndeshje futbollit, atë mes Iranit dhe Spanjës.





DASHI 21. mars - 20. prill

Te dashuruarit nuk do i kushtojnë vëmendjen e duhur personave që do kenë në krah dhe kjo mund të sjellë pakënaqësi. Nëse jeni beqare do ndiheni mire me atë status dhe nuk do keni nevojë për asnjë person. Se bashku me miqtë mund të përjetoni kënaqësi pa fund. Në planin financiar do keni një situatë goxha të qëndrueshme dhe do kryeni disa shpenzime me tepër.



DEMI 21. prill - 21. maj

Marrëdhënia në çift do jete shume e mire gjate kësaj dite dhe ju do ndiheni për mrekulli në krahët e atij që dashuron. Ai mund t'iu plotësojë edhe disa nga dëshirat me të zjarra. Beqaret do takojnë një person i cili do i mahnite. Duke e pasur mendjen tek ai do harrojnë edhe të hane e të pine. Financat do kenë disa përmirësime të vogla.



BINJAKET 22. maj - 21. qershor

Nëse tregoheni shume impulsive në jetën tuaj në çift mund të bëni gabime të pafalshme. Mos e prishni me dorën tuaj atmosferën e ngrohtë që është krijuar. Beqaret do kërkojnë pa pushim, por nuk do e gjejnë askund princin e tyre të kaltër. Në planin financiar këshillohet të mos e teproni me shpenzimet sepse situata mund të përkëqësohet me tepër sesa mendoni.



GAFORRJA 22. qershor - 22. korrik

Ata që janë në çift do kenë probleme serioze sot. Te dy do jeni kokëfortë dhe do doni të dale juaja. Nëse vazhdoni me këtë sjellje nuk keni për të shkuar askund. Beqaret do jete të shoqërueshëm dhe të qeshur me gjithë personat që do takojnë. Kjo do beje që edhe propozimet të jene të shumta dhe serioze. Në planin financiar shpenzoni aq sa ua mban xhepi.



LUANI 23. korrik - 22. gusht

Nëse keni pasur zënka me partnerin tuaj, hidhni vete hapin e pare drejt pajtimit. Në këtë mënyrë marrëdhënia juaj do jete edhe me e ngrohte. Beqaret do përzgjedhin shume dhe serish do ngelen vetëm. Pranoni të paktën të njiheni me ta. Financa do jene mjaft të stabilizuara dhe do kryeni shpenzimet e nevojshme. Me ne fund!



VIRGJERESHA 23. gusht - 23. shtator

Dite shume e qëndrueshme kjo e sotmja për të dashuruarit. Do bini dakord për gjithçka me atë që keni në krah dhe gjithçka do shkoje me se miri. Beqaret do kenë një dite të këndshme edhe pse nuk do e gjejnë dot shpirtin e tyre binjak. Në planin financiar do jeni mjaft të zotet dhe do e stabilizoni situatën. Gjithçka do shkoje me se miri në këtë fushe.



PESHORJA 24. shtator - 23. tetor

Rrethanat do bëjnë të mundur që lidhja juaj të përmirësohet sot. Megjithatë do ketë edhe shume për të bere ende. Tregohuni me tolerante dhe mos kërkoni nga partneri sakrificë. Beqaret do joshin pa pushim por as sot nuk do e gjejnë dot personin e ëndrrave. Beni durim! Planetët do iu ndihmojnë në planin financiar. Do ruani një klimë të qëndrueshme dhe do tregoheni të matur me shpenzimet.



AKREPI 24. tetor - 22. nëntor

Te gjithë planetët do jene të favorshëm gjate kësaj dite për jetën tuaj në çift, por Plutoni do jete ai që do sjelle me shume të mira. Nëse jetoni bashkë dita do jete me sensuale dhe e lumtur. Beqaret do ndihen të pashprese, pa e ditur se një surprizë e madhe i pret në mbrëmje. Në sektorin e financave gjerat do shkojnë mire. Ju duhet vetëm të ulni pak shpenzimet dhe nuk do keni probleme.



SHIGJETARI 23. nëntor - 21. dhjetor

Gjate kësaj dite do jeni shume strikte në jetën sentimentale dhe nuk do i lini partnerit aspak liri veprimi. Kujdes sepse situata mund të përkëqësohet dhe ju do vuani me shume. Beqaret do jeni mjaft kërkues dhe nuk do e gjejnë dot atë që kane në mendjen e tyre. Në sektorin e parave mos bëni asnjë investim të madh sepse do keni shume pasoja. Hiqni nga pak lek mënjani, vetëm kështu do rrisni buxhetin.



BRICJAPI 22. dhjetor - 20. janar

Dita do jete e vështirë për të gjithë ata që janë në çift sot. Disa munde të largohen paksa nga i dashuri, e ata që kane pasur edhe me pare probleme mund të ndahen. Beqaret duhet të bëjnë edhe pak durim dhe mos tentojnë sot nëse duan të gjejnë personin e duhur. Tregohuni shume të matur në planin financiar, por dhe mos ngurrtoni të merrni iniciativa për të përmirësuar buxhetin.



UJORI 21. janar - 19. shkurt

Jeta private dhe çështjet e zemrës do kenë prioritet gjate kësaj dite. Beqaret do kenë takime pasionante dhe nuk do ngurojnë të krijojnë lidhje. Merkuri do i beje ata që janë në çift me kërkues dhe të pakënaqur. E keni menduar ndonjëherë sa jepni ju për partnerin? Nëse mundoheni të arrini rezultate në pune do keni edhe përmirësim të financave, përndryshe situata do jete delikate.



PESHQIT 20. shkurt - 20. mars

Do bëni çmos që ta largoni rutinën nga jeta juaj në çift gjate kësaj dite dhe do ja dilni bane me sukses. Emocionet do jene me të shumta dhe me të veçanta se kurrë. Beqaret do marrin disa propozime, por nuk do e kenë të lehte të vendosin se cilin do zgjedhin. Në planin financiar do jeni të privilegjuar dhe situata do përmirësohet ndjeshëm.

Mensur Mamuti	DHOMA E PUNËS ISH FUTBOLLISTI ITALIAN NË FOTO	Z	USHTARAKU FRËNG, NAPOLEONI NJË NGA KLUBET E FUTB. NË FOTO	B	BANUESIT PËRRETH NILIT
ISH KRYETARI I RODEZISE, KLIFORD					
PERSIA					
TENISTI SPANJOLL, RAFAEL					
OZONI		ONEPLUS ONE QYTET NË KROACI			
FUÇI PARALAJMERUESE E ANJUEVE (SH)					
LËNDË QË PËRDORET PËR EMBËLSIRA (SH. PASHQ.)					
XH. U.			TEFTA TASHKO VUA E CILA, NË PJESËN ANËSORE, PËRET DY PIKA NË HARK		
HUMORISTI SHQIPTAR, BYLYKU					NJË NGA KLUBET E FUTBOLLISTIT NË FOTO
KOHA	INTERNET EXPLORER VË NË ARKIV			INTENSITETI OSMIUMI	SHKOLLIM, NJOHURI PJESË E GJURIT
NJË NGA KLUBET E FUTBOLLISTIT NË FOTO					PËRKULI NË RREGULL
RUMANIA		SPECIALIST I ASTRONOMISË QYTET NË TRABZON			
TRUP GJEOMETRIK				ESKIMEZ NË ATË VEND	
DARKA E RAMAZANIT					BANJË SHËRUESE VULLKAN NË JAPONI
VOLTI		ITRIUMI DAJAK		MODEL ONTARIO	
ROMAN I ANTON PASHKUT			NEGACION YNË VOLTI		FAMË TEMPERATURA
NJË NGA KLUBET E FUTBOLLISTIT NË FOTO					KALIUMI



ZGJIDHET: Z, B, DYPON, IRANI, NADAL, O, OPO, BOVAT, AGARË, XHU, TT, OLSI, IE, I, M, ANKONA, EPI, R, ASTRONOM, KON, ESKIM, IFTARI, SPA, Y, IT, MAKET, OH, JO, BUJA, JUVENTUS, K.

Shumë i lehtë **Sudoku** **mesatar**

6	2		8	1				5						7		
						7					5			4		6 8
			8	6	9			1			2	3				7
				9		1	6		3				1	4	6	
											8	1				3
2		9	7		5						9				5	
	4		1	7		9					7	4				
					9			4			8	9		1		
3			2	5				6						3	2	

Shumë i lehtë: 627813495, 913547268, 458692317, 584921673, 176438529, 239765841, 845176932, 762389154, 391254786. Mesatar: 148657923, 735294168, 962381457, 253146789, 481579632, 697823541, 374962815, 829415376, 516738294.



I ka mbushur 24 vjet, por nëna e Justin Bieber i del kundër fejesës

Ylli i muzikës Justin Bieber së fundi ka qenë pjesë e çdo medie për shkak të fejesës së tij me modelen e njohur Hailey Baldwin. E siç duket kundër kësaj fejesë po del të jetë nëna e këngëtarit Pattie Mallette. Nëna e tij ka lënë të kuptohet se nuk e ka dëshiruar këtë fejesë. Krijuesi i hitit "Sorry" ditë më parë ka njoftuar se ai dhe tani më e fejuara e tij Hailey, së shpejti do të martohen, mirëpo sipas disa fansave, nëna e tij është e nervozuar rreth këtij vendimi. Deri më tani në biografinë e Pattie't në Twitter shkruhej "Po, Justin Bieber është biri im", mirëpo vetëm disa orë pasi që 24 vjeçari e shpall fejesën e tij, nëna e hoqi këtë mbishkrim nga biografia.

Më vonë është parë se ajo i ka pëlqyer disa postime në Twitter në të cilat flitej rreth fejesave të ngutura, edhe pse asnjëra prej tyre nuk i referohej Justin dhe Hailey't. Nuk dihet për Hailey, por nëna e Justin e ka dashur partneren e mëparshme të Justin, Selena Gomez. "Nuk di shumë rreth lidhjes së tyre personale, por une e dua Selenën", kishte thënë më herët Pattie. Kujtojmë se Justin ka qenë edhe më herët në lidhje me Hailey'n por ishin ndarë, derisa pas bashkimit të fundit ata edhe u fejuan.

NË TRE VITET E FUNDIT JANË PARANDALUAR 645 VETËVRASJE NGA URAT E STAMBOLLIT



Policia turke ka shpëtuar jetët e 645 personave të cilët kishin tentuar të kryejnë vetëvrasje duke u hedhur nga urat e Stambollit në tre vitet e fundit. Në vitin 2015, Zyra për Siguri në kuadër të policisë së Stambollit themloi një "ekip negociues" i cili është përgjegjës për urat në qytet, me qëllim të parandalimit të tentativave për vetëvrasje nga urat Dëshmorët e 15 Korrikut, Fatih Sultan Mehmet Bridge dhe Yavuz Sultan Selim. I përbërë nga 25 oficerë policie, ekipi në fjalë fillimisht ishte trajnuar në fushat e psikologjisë, komuniukimit gjatë situatave të krizës, bindjes, gjuhës së trupit dhe kontrollit të mllëfit. Pjesëtari i ekipit, Mehmet Ali Demir, thotë se gjëja e parë që bëjnë është se njihen me personin i cili tenton të vetëvritet. Demir thotë se metoda e tyre gjatë trajtimit varet shumë nga

informacionet të cilat i marrin ndërkohë për personin në fjalë. "Fillimisht, largojmë kureshtarët nga ura. Nuk bëjmë kontakt fizik me personin me të cilin negociohet së paku për një orë e gjysmë", tha për AA anëtari tjetër i ekipit, Saadetin Çakır. Çakır rrëfen se një i ri, të cilin e kishin bindur të mos vetëvritet, pas disa vitesh i kishte vizituar me diplomë universitare. Në një tjetër rast, thotë ai, një student ishte varur nga ura dhe po mbahej për rrethojën e sigurisë, ndërkohë që kishte vërejtur gjatë negociatave se duart e tij po rreshqisnin ngadalë. "Kur e pyeta nëse dëshiron ta ngre lart, ai më tha: 'Shpëtom, vëlla', pas çka dhe e ngrita lart mbi urë", tregon Çakır. Pjestarët e ekipit në fjalë thonë se është e një rëndësie jetike të kuptohen arsyet të cilat çojnë drejtë tentativës për vetëvrasje.

Kenga e sëpatave te çmendura...

E kisha këtë frikë...vjetë ju prenë degët e trasha...sivjetë edhe trungjet...po pse a ka mundësi një sqarim...Nga trungu në foto pema duket vitale...kujt i paska prishur punë pema e Ekualiptit...gjate femijerisë sime kaloja aty pari...i prekja ndjeja aromën e tyre dhe ecja zbatthur si çdo femijë i asaj kohe mbi ato kokriza qe leshonin keto pemë të cilat u mbollën në kohën e mbreterisë...Sepse mu kujtua që në Hungari u vonua inagurimi i një metroje sepse në njerin nga stacionet e caktuara do duhej te pritej nje pemë...pema nuk u pre, u çvendos stacioni...pasi mbollë 100 mijë pema...po ja po bëjmë se po besojmë premë keto pemë...pse na e dhunuat femijerinë...Kenga e sëpatave te çmendura.../Perparim Kabo



G-Power Mercedes-AMG C 63 S me 600 kuajfuqi



Një tjetër model i Mercedes-AMG i cili ka kaluar nëpër duart e kompanisë së njohur gjermane G-Power, është ky C 63 S (W205). Motori i këtij modeli, 4.0-litër Twin-Turbo V8, është përforcuar në 600

kuajfuqi, që nënkupton se tani ka 90 kuajfuqi më shumë sesa modeli standard. Gjithashtu, tani ky Mercedes-AMG C 63 S (W205) shpejtësinë nga 0 deri në 100 kilometra në orë e arrin për 3,8 sekonda

ndërsa atë maksimale "mbi" 300 km/h. G-Power, po ashtu, ofron edhe set të ri të rrotave Hurricane RR nga alumini e diametër prej 20-inç (komplet me goma kushtojnë 6,680 euro).



KALENDARI HISTORIK 24 KORRIK

1148 - Luigji VII i Francës vendos rrethimin e Damaskut gjatë Luftë së II të Kryqëzatave.

1411 - Fillon Beteja e Harlaut, në prej betejave më të përgjakshme në Skoci.

1577 - Armata spanjolle/mercenarët gjerman pushtojnë Namurin.

1683 - Vendosen banorët e parë nga Gjermania në SHBA.

1704 - Trupat anglez dhe holandez okupojnë Gjibraltarin.

1783 - Gjeorgjia bëhet protektorat i Rusisë cariste.

1823 - Robëria shfuqizohet në Kili.

1883 - Arabi Pasha shpall luftë të shenjtë në Egjipt.

1923 - Forcat e Aleancës dhe Turqia nënshkruajnë traktat të paqes në Lozanë.

1938 - Zbulohet instant kafeja.

1941 - Nazistët ekzekutojnë tërë popullatën e hebrenjve në Grodz të Lituaniës.

1948 - Sovjetët bllokojnë Berlinin nga perëndimi.

1969 - Muhammad Ali dënohet për shkak të refuzimit për inkuadrim në ushtrinë amerikane.

2007 - Libia liron të të gjashtë mjekët e akuzuar për çështjen e HIV-it në Libi.

Emri i Pinokut në gjuhën italiane do të thotë Kokë pishe.



Peshkaqeni lëvizë edhe kur fle ose lëvizë



Shumica e lopëve prodhojnë më shumë qumësht kur dëgjojnë muzikë



Fqinja

Një grua i thotë fqinjës së vet Moj pse zihesh përnatë me burrin në shtëpi? Nuk është burri është dashnori, bëhet xheloz se unë fle me burrin!!! Turp të kesh i thotë fqinja tradhton dashnorin me burrin

Burri dhe gruaja

Një burrë priste gruan që po kthehej nga shtëpia e nënës. Më në fund ajo erdhi: -Tjeta, si je?-i thotë burri. -Booo, sa ftohte me pret!-i thotë ajo. -Pa shiko atë burrin se sa ëmbël po e pret gruan, po e puth, po e për-qafon... -E ke gabim, ai nuk po e pret, por po e përcjellë!



"Askush nuk ta jep barazinë apo lirinë, nëse je burrë, qohu dhe merre"

Malcolm X



A E DINI SE...



BARSOLETA



THËNIA E DITËS